

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5600  
E premte, 12 tetor 2018  
çmimi 0.40 €

## Kosovës i avancohet statusi në Frankofoni, bëhet anëtare e asociuar



FAQE 3

Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", HYSNI GUCATI | FAQE 4-5

## OVLUÇK-ja kërkon riverifikim të plotë të veteranëve

Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Hysni Gucati, ka kërkuar që procesi i verifikimit të veteranëve të kthehet në pikën zero. Ai ka thënë se është në të mirën e të gjithëve që të ndodhë një riverifikim i plotë i tyre. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Gucati ka deklaruar se për veteranët e "rrejshëm" dhe keqpërdoruesit e listave duhet të nxirret Ligji për amnisti. Sipas tij, ata duhet të falen, por duhet t'i dorëzojnë certifikatat. Mirëpo, nëse në afatin e paraparë nuk dorëzohen certifikatat, Gucati ka thënë se ata duhet të dënohen dhe t'i kthejnë mjetet. Ai ka theksuar se politika e ka prishur këtë proces dhe ajo duhet ta rregullojë. Gucati ka bërë me dije se nuk do të ketë ndërprerje të pensioneve pa vendim të gjykatës



## Dështon përpjekja për unifikimin e pozitës dhe të opozitës për dialogun

Ftesës së kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, lidhur me rezolutën e propozuar për dialogun me Serbinë nuk i janë përgjigjur të mërkurën LDK-ja dhe Vetëvendosja, por i janë përgjigjur përfaqësuesit e Partisë Socialdemokrate dhe të Alternativës. Në këtë takim, në të cilin morën pjesë përfaqësuesit e të gjitha partive shqiptare në pushtet, Veseli



ka bërë thirrje për unitet rreth platformës për dialogun me Serbinë | FAQE 7

## Punimet për Termocentralin 'Kosova e Re' do të fillojnë vitin e ardhshëm



FAQE 7

### AKTUALE

**VLERËSOHET E QËNDRUESHME SITUATA E SIGURISË NË MITROVICË** F. 11

**MINISTRI BYTYQI: TË PUNOJMË SË BASHKU PËR NXITJEN E DIVERSITETIT NË SHKOLLA** F. 6

**PASTROHET LIQENI I BATLLAVËS** F. 3

### EKONOMI

**MTI-ja OFRON PARTNERITET PËR ADRESIMIN E SFIDAVE TË SEKTORIT PRIVAT** F. 8

**ÇMIMET E KONSUMIT SHËNUAN RITJË** F. 8

### KULTURË

**NDËRRON JETË SHKRIMTARI FATOS ARAPI** F. 2



### SPORT

**EDHE NJË TRIUMF I KOSOVËS NË 'FADIL VOKRRI', RRËZON MALTËN** F. 16



**KB PRISHTINA MËSON KUNDËRSHTARËT NË FIBA EUROPE CUP** F. 16

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Curëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA** GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANK VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Vuçiqi e pranon që ka dështuar ndarja e Kosovës

BEOGRAD, 11 TETOR - Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka folur të enjten rreth idesë së korigjimit të kufijve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke konfirmuar edhe një herë zmbarsjen e tij karshi një nisme të tillë që zuri fill në Forumin e Alpbachut në Austri në takimin e përbashkët me presidentin e Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi. Ai ka

thënë se populli po dëshiron që kufijtë ndërmjet dy shteteve të jenë në Jarinjë dhe Bërnjak. "Nëse thotë populli, ashtu do të bëjmë. Ne nuk mund të dalim kundër dëshirave të popullit. Duhet të pajtohemi dhe respektojmë vullnetin e popullit. Por dua t'ia rikujtoj popullit se unë isha për një marrëveshje tjetër", u ka thënë presidenti serb Vuçiq

medieve serbe. Megjithatë, Vuçiqi në një formë ka vazhduar ta mbrojë idenë e tij, duke thënë se pas 20 vjetësh populli do ta vlerësojë atë. Ai ka folur edhe rreth deklaratave të anëtarit të ri të Presidencës nga radhët e kroatëve, Zdravko Komshiq, të ketë thënë se Republika e Kosovës për Bosnjën është një shtet i pavarur.



## Padi të reja kundër Gruevskit dhe ish-ministrave të tij

Për shpërdorimin e detyrës zyrtare Prokuroria Speciale e Maqedonisë ka akuzuar ish-kryeministrin Nikolla Gruevski dhe disa ish-ministra dhe shumë zyrtarë të tjerë të lartë dhe drejtues dhe anëtarë të komisioneve të tenderit. Sipas Prokurorisë, të akuzuarit dyshohet se kanë dëmtonuar buxhetin e shtetit rreth 80 milionë euro



SHKUP, 11 TETOR - Prokuroria Speciale e Maqedonisë njoftoi të mërkurën për nisjen e hetimeve për raste të reja që kanë të bëjnë me shpërdorimin e detyrës zyrtare. Në mesin e të akuzuarve janë ish-kryeministri Nikolla Gruevski, ish-ministri i Financave, Zoran Stavreski, ish-ministri i Transportit dhe Lidhjeve, Mile Janakievski, ish-ministri i Shëndetësisë, Bujar Osmani, dhe shumë zyrtarë të tjerë të lartë dhe drejtues e anëtarë të komisioneve të tenderit. Sipas Prokurorisë Speciale Publike, të akuzuarit dyshohet

se kanë dëmtonuar buxhetin e shtetit me rreth 80 milionë euro.

Ish-kryeministri dhe ish-ministrat akuzohen në gjashtë raste të veçanta të koduara me emrat: "Dhurata", "Propaganda", "Dizajni", "Harmonia", "Stacionet bazë" dhe "Pacienti".

Hetimet përfshijnë periudhën nga viti 2010.

Nga personat e akuzuar, ish-ministri i Shëndetësisë, Bujar Osmani, në Qeverinë e tanishme është zëvendëskryeministër për çështje evropiane dhe

zyrtari i parë i partisë shqiptare Bashkimi Demokratik për Integritim (BDI), i cili akuzohet nga Prokuroria Speciale për shpërdorime kur kjo parti ishte në pushtet me VMRO-DPMNE-

në - tani parti në opozitë.

Në një reagim me shkrim të Osmanit, theksohet habia e tij, ndërsa shkruan se kishte dëgjuar edhe më parë spekulime në media. "Hetimin e iniciuar e kon-

sideroj si normal, korrekt dhe obligim profesional të Prokurorisë dhe në atë drejtim jam në dispozicion të Prokurorisë Speciale Publike, si dhe në cilindo organ tjetër të drejtësisë në vend, për bashkëpunim në interes të identifikimit të gjendjes faktike në tërësi. Dua të theksoj se nuk kam asgjë për të fshehur, përkundrazi pres një hetim më të shpejtë dhe më efikas me qëllim të vetëm të zbardhet e vërteta - se as që kam ndikuar dhe as që kam mundur të ndikoj e aq më pak nuk kam mundur të jem i njoftuar me keqpërdorime eventuale, sigurisht nëse ekziston një gjë e tillë", thuhet në reagimin e Bujar Osmanit.

Ish-kryeministri Nikolla Gruevski është duke u gjykuar edhe për vepra të tjera, ndërsa për një prej tyre është dënuar me dy vjet burgim. Akuzat e Prokurorisë Speciale kanë për bazë bisedat e përgjuara telefonike, të publikuara në shkurt të vitit 2015.

## Zaevi: I kemi votat e nevojshme për ndryshimet kushtetuese

SHKUP, 11 TETOR - Kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev, ka deklaruar se deputetët e opozitës e kanë kuptuar nevojën për t'i mbështetur ndryshimet kushtetuese për çështjen e emrit. Ai ka përmendur edhe kërcënimet e deputetëve opozitarë për të mos ndryshuar qëndrimin rreth kësaj çështje. "Mbrëmë isha në sallë me deputetët, por më pas edhe në bufe dhe biseduam me të gjithë. Të gjithë janë të vetëdijshëm dhe e kanë të qartë

se nuk ka plan B. Nëse kjo mundësi bie, çfarë më pas? Të gjithë janë të ngarkuar nga mendimi, çfarë më pas nëse edhe këtë herë dështojmë? Numri është shumë i madh edhe tek opozita. Njerëzit besojnë dhe janë njerëz që vijnë nga shoqëria, politikanë, deputetë etj. Kërcënimet që po i përjetojnë janë një ndër arsyt që po i detyron të mos i ndryshojnë qëndrimet. Të gjithë janë të përgjegjshëm si shumica ashtu



edhe opozita. E dinë shumë mirë të gjithë, ashtu si unë, që ky shans duhet shfrytëzuar sepse nuk përsëritet më", ka thënë Zaevi. Sipas tij, të gjitha kërcënimet ndaj deputetëve të VMRO-së do të dështojnë.

"Secili mendim, se goja me presion, para, blerje, kërcënime dhe nënçmime do të bëjë diçka, në hapin e dytë do të bjerë. Duhet patjetër të jetë e përballeshme sepse është patjetër të kemi ardhmëri. Duhet që njerëzit të

besojnë në të dhe të mbajnë përgjegjësi. Për këtë shkak çdoherë e përdor fjalën atmosferë miqësore, bisedime, interaktivitet, proces i brendshëm sepse vetëm kështu është e mundur. Do ta shohim, këto ditë do të ndodhin gjërat. S'ka fjalë se Maqedonia do të shkojë në NATO dhe BE. Shpresoj që të mos harxhojmë kohë, sepse jo çdo vit dhe çdo muaj, por çdo ditë është e rëndësishme", është shprehur Zaevi.

## Vdes shkrimtari i njohur Fatos Arapi

Tiranë, 11 tetor - Është ndarë nga jeta në moshën 88-vjeçare shkrimtari i njohur shqiptar, Fatos Arapi. Arapi lindi në vitin 1929 në Vlorë. Po atje ai kreu

shkollën e mesme, ndërsa studimet e larta i ndoqi në Bullgari (Sofje) në Fakultetin e Matematikës dhe të Ekonomisë. Ka punuar shumë

vjet gazetar dhe pedagog në Fakultetin Histori-Filologji të Tiranës. Disa herë ka fituar çmime kombëtare e ndërkombëtare për poezi. Në vitin 2008

e fitoi "Kurorën e artë" në manifestimin poetik "Mbrëmjet e poezisë strugave" dhe është i pari poet shqiptar që e ka fituar këtë shpërblim.



Republika e Kosovës ka ndryshuar statusin në Organizatën Ndërkombëtare të Frankofonisë

# Kosovës i avancohet statusi në Frankofoni, bëhet anëtare e asociuar

Republika e Kosovës ka ndryshuar në mënyrë pozitive statusin në Organizatën Ndërkombëtare të Frankofonisë. Në Samitin e 17 të kësaj organizate, që po mbahet në Jerevan të Armenisë, shtetet anëtare kanë votuar unanimisht që nga anëtari vëzhgues Kosova të kalojë në anëtar të asociuar të kësaj organizate. Udhëheqësit shtetërorë të Kosovës që po marrin pjesë në këtë samit kanë mirëpritur këtë votim dhe kanë falënderuar të gjitha shtetet që kanë mbështetur Kosovën

**EPOKA  
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 11 TETOT - Në Samitin e 17 të Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë shtetet anëtare kanë votuar unanimisht që Republikës së Kosovës t'i avancohet statusi në këtë organizatë, nga vëzhguese në anëtare të asociuar.

Udhëheqësit e shtetit të Kosovës, që po marrin pjesë në punimet e këtij samiti në Jerevan të Armenisë, kanë mirëpritur këtë votim, duke i falënderuar të gjithë krerët e shteteve që kanë mbështetur Kosovën në këtë proces. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se ky është lajm i mirë për shtetin e Kosovës. "Lajmi i mirë i radhës për Kosovën vjen nga Armenia. Nga vëzhguese, Kosova u bë anëtare e

asociuar e Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë. U jemi mirënjohës shteteve anëtare për afirmimin e Kosovës në familjen frankofone dhe për mbështetjen e vazhdueshme të tyre", ka shkruar presidenti Thaçi në profilin e tij në "Facebook". Ndërsa zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme të Kosovës, Behgjet Pacolli, avancimin e statusit të Kosovës në Frankofoni e ka vlerësuar si sukses të madh të diplomacisë kosovare. "Sukses i madh i diplomacisë sonë në Organizatën Ndërkombëtare të Frankofonisë. Republika e Kosovës sapo u pranua me statusin e anëtarit të asociuar në Organizatën e Frankofonisë, që është organizatë shumë e fuqishme politike dhe e dyta në botë për nga rëndësia, pas OKB-



së. Faktorizimi i Kosovës në botë po shënon suksese. Falënderim për të gjithë anëtarët e MPJ-së që u angazhuan palodhshëm për këtë sukses të madh", ka shkruar Pacolli në profilin e tij në "Facebook". Ndryshimin e statusit të Kosovës në Organizatën Botërore të Frankofonisë e ka mirëpritur edhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, i cili po merr pjesë në këtë

samit. "Kosova kalon sprovën e miratimit dhe kthehet nga vëzhgues në anëtar i asociuar i Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë. Urime Kosovës dhe të gjithë atyre që punuan për këtë votim me rëndësi për ecurinë e shtetit tonë të dytë", ka shkruar Rama. Një ditë më parë kërkesën për ndryshim të statusit të Kosovës e kishte bërë ministri i Jashtëm i

Kosovës, Behgjet Pacolli. Në mesin e krerëve të shteteve që po marrin pjesë në këtë samit janë edhe presidenti i Francës, Emmanuel Macron, kryeministri i Kanadasë, Justin Trudeau, Princi Albert II i Monakos, si dhe shumë liderë të tjerë të vendeve frankofone. Organizata Ndërkombëtare e Frankofonisë është themeluar në vitin 1970, ndërsa ajo përbëhet prej 84 shteteve dhe qeverive.

## Pastrohet liqeni i Batllavës



PODUJEVË, 11 TETOR (ER) - Mbi 150 thasë me mbeturina dhe tetë tonë mbetje janë larguar gjatë aksionit të së enjtes te liqeni i Batllavës, ku u pastruan tri deponi të mbeturinave si dhe një hapësirë përreth liqenit (500 metra gjatësi). Në aksionin për pastrimin e liqenit të Batllavës morën pjesë mbi 100 vullnetarë, pjesëtarë të komunitetit lokal dhe një grup nxënësish.

Aksioni u realizua në kuadër të projektit "Improved Waste Management for Improved Water and Environment Protection" që financohet nga Ambasada e Kanadasë. Drejtori ekzekutiv i Let's Do It Kosova, Luan Hasanaj, ka thënë se hapësirat përreth liqenit të Batllavës janë në gjendje jo të mirë pavarësisht që janë pastruar disa

herë. "Ne nuk po pajtohemi me këtë situatë dhe po mundohemi që disa herë të vijmë dhe të pastrojmë këtu. Qëllimi kryesor i krejt kësaj është të provokojmë debat dhe të mundohemi t'u tregojmë qytetarëve që ju duhet me qenë më të kujdesshëm, më të vetëdijshëm, që duhet ta ruajmë këtë hapësirë, duhet ta ruajmë mjedisin ku ne jetojmë, sepse është vend që ne e

shfrytëzojmë të gjithë. Nëse e dëmtojmë dhe e krijojmë si kjo këtu, nuk e di se çfarë e ardhme na pret neve dhe gjeneratave që vijnë", ka thënë Hasanaj. Ai ka thënë se po bëjnë përpjekje që te liqeni i Batllavës të vendosen ulëse dhe shporta. Ky aksion është organizuar në bashkëpunim me Task Forcën lokale të Komunitetit të Podujevës, e cila është themeluar

në kuadër të Fushatës "Ta Pastrojmë Kosovën". Gjithashtu, në këtë aksion morën pjesë edhe vullnetarë nga Organizata Joqeveritare "Sundimi i demokracisë". Po në këtë aksion për pastrimin e liqenit të Batllavës është angazhuar edhe kompania "Natyra" me ekskavatorë dhe kamionë për largimin e mbeturinave.

Flet për "Epokën e re", Hysni Gucati

# OVLUÇK-ja kërkon riverifikim

Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Hysni Gucati, ka kërkuar që procesi i verifikimit të veteranëve të kthehet në pikën zero. Ai ka thënë se është në të mirën e të gjithëve që të ndodhë një riverifikim i plotë i tyre. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Gucati ka deklaruar se për veteranët e "rrejshëm" dhe keqpërdoruesit e listave duhet të nxirret Ligji për amnisti. Sipas tij, ata duhet të falen, por duhet t'i dorëzojnë certifikatat. Mirëpo, nëse në afatin e paraparë nuk dorëzohen certifikatat, Gucati ka thënë se ata duhet të dënohen dhe t'i kthejnë mjetet. Ai ka theksuar se politika e ka prishur këtë proces dhe ajo duhet ta rregullojë. Gucati ka bërë me dije se nuk do të ketë ndërprerje të pensioneve pa vendim të gjykatës

**EPOKA E RE**

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 11 TETOR - Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Hysni Gucati, ka thënë të enjten se është në të mirën e të gjithëve që të ndodhë një riverifikim i plotë i veteranëve. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka kërkuar që procesi i verifikimit të veteranëve të kthehet në pikën zero si dhe të amnistohen veteranët e "rrejshëm". "Për veteranët e 'rrejshëm' dhe keqpërdoruesit e listave duhet të nxirret Ligji për amnisti, pra ata të falen dhe t'u jepet një afat i caktuar për t'i dorëzuar certifikatat. Në rast se deri në afatin e paraparë nuk dorëzohen certifikatat automatikisht, sipas ligjit, ata duhet të sillen para drejtësisë dhe ta marrin dënimin e merituar dhe t'i kthejnë mjetet. OVLUÇK-ja kërkon që procesi të kthehet në pikën zero, pastaj të ndodhë një riverifikim i plotë i veteranëve si dhe të aprovohet Ligji për amnisti", ka deklaruar ai.

Gucati u ka bërë thirrje institucioneve ta përkrahin këtë proces, duke thënë se politika e ka prishur dhe ajo duhet ta rregullojë. "Te fryrja e listave nuk ka faj vetëm hierarkia ushtarake, por edhe politika. Këtë politika nuk mund ta fshehtë. Nuk po dua t'i mbroj komandantët, por politika i ka bërë këto për çështje të votave. Madje këtu politika ka dorë të fortë. Politika e ka prishur, prandaj pikërisht politika duhet ta rregullojë. Kësisoj duhet të prishet ky proces dhe të fillojë një proces i ri. U bëjmë thirrje të gjitha institucioneve për të na mbështetur që të dalim prej kësaj krize dhe procesi të kthehet në rivlerësim. Në këtë drejtim presim nga Kuvendi miratimin e Ligjit për amnisti", është shprehur Gucati.

Ai ka bërë me dije se nuk do të

ketë ndërprerje të pensioneve pa vendim të gjykatës. "Nuk besoj që ka diku në botë ligj që i ndal pensionet pa vendim të gjykatës. Nuk mund të ndalen pensionet sepse tashmë janë përzier listat. Janë mbi tre mijë veteranë të vërtetë që janë pjesë e listës së veteranëve të rrejshëm. Tash atyre nuk mund t'u ndalen pensionet. Një pjesë e tyre janë edhe themelues të UÇK-së. Nuk guxojmë të kërkojmë ndaljen e pensioneve për ata 20 mijë persona ku në mesin e tyre janë mbi tre mijë veteranë të vërtetë. Prokuroria duhet ta kryejë punën e vet dhe të vërtetojë kush ka qenë veteran dhe kush manipulues", ka theksuar Gucati.

**"Epoka e re":** Z. Gucati, Gjykata Themelore në Prishtinë e ka kthyer në Prokurorinë Speciale aktakuzën për çështjen e fryrjes së listave të veteranëve të UÇK-së. Si e komentoni këtë vendim?

**Gucati:** Nuk dëshiroj të përzihem në punën e drejtësisë. Si duket, ata e kanë parë të arsyeshme që kjo çështje të kthehet në Prokurori. Por ne kemi prituri që të ndodhë një gjë e tillë. Prandaj shpresoj se prokuroria dhe gjykata do ta marrin një vendim të drejtë për ta çuar deri në fund procesin e listave të fryra. Edhe unë besoj se listat janë të fryra. Për mendimin tim, ky është një hap i mirë sepse ky proces duhet të kthehet në pikën zero dhe çdo gjë të nisë nga e para.

**"Epoka e re":** Cili, sipas jush, do të ishte ky vendim i drejtë?

**Gucati:** Nëse gjenden defekte në këtë proces atëherë gjykata duhet ta marrë vendimin për korrigjim. Nëse nuk e bën një gjë të tillë, nuk është mirë të manipulohet me emra dhe persona të caktuar. Rasti duhet të shkojë deri në fund. Për OVLUÇK-në është me rëndësi që procesi të kthehet në pikën zero, pastaj të bëhet siç duhet riverifikimi i veteranëve të UÇK-së.

**"Epoka e re":** Në vazhdimësi ju keni kërkuar që procesi i verifikimit të kthehet në pikën zero. Sa ka gjasa të ndodhë një gjë e tillë?

**Gucati:** Procesi i verifikimit të veteranëve të UÇK-së mund të kthehet në pikën zero nëse liderët politikë duan të punojnë në të mirën e veteranëve. Nëse ata pajtohen për këtë, besoj shumë se do të ketë sukses. Çdo gjë është në dorën e tyre. Liderët politikë duhet të miratojnë në Kuvend Ligjin për amnisti në mënyrë që të rivlerësohen edhe një herë aplikacionet e veteranëve që ta zgjidhim si duhet këtë problem. Edhe fëmija në djep e di se Kosova nuk i ka pasur 60 mijë ushtarë. Është turp i madh të thuhet se kanë qenë 60 mijë veteranë. OVLUÇK-ja është e interesuar

të bëhet edhe një herë regjistrimi i tyre.

**"Epoka e re":** Do të jetë i vështirë riverifikimi?

**Gucati:** Absolutisht nuk do të jetë i vështirë. Nisja e verifikimit të veteranëve nga e para do të jetë shumë e kollajshme sepse aplikacionet janë pranë Zyrës së Kryeministrit dhe kërkohet vetëm riverifikimi i tyre. Kjo nuk do të merrte shumë kohë dhe mund të kryhet brenda 90 ditëve. Është gënjeshtër nëse thuhet se ky proces do të marrë shumë kohë.

**"Epoka e re":** Çfarë do të ndodhë me këta veteranë e 'rrejshëm'?

**Gucati:** Për veteranët e 'rrejshëm' dhe keqpërdoruesit e listave duhet të nxirret Ligji për

amnisti, pra ata të falen dhe t'u jepet një afat i caktuar për t'i dorëzuar certifikatat. Në rast se deri në afatin e paraparë nuk dorëzohen certifikatat automatikisht, sipas ligjit, ata duhet të sillen para drejtësisë dhe ta marrin dënimin e merituar dhe t'i kthejnë mjetet. OVLUÇK-ja kërkon që procesi të kthehet në pikën zero, pastaj të ndodhë një riverifikim i plotë i veteranëve si dhe të aprovohet Ligji për amnisti.

**"Epoka e re":** Meqë aktakuza është kthyer sërish në prokurori, mund të ketë një lloj pezullimi të pensioneve të këtyre që janë apostrofuar si veteranë të 'rrejshëm'?

**Gucati:** Nuk besoj se ka diku në botë ligj që i ndal pensionet pa vendim të gjykatës. Nuk mund

# im të plotë të veteranëve



të ndalen pensionet sepse tashmë janë përzier listat. Janë mbi tre mijë veteranë të vërtetë që janë pjesë e listës së veteranëve të rrejshëm. Tash atyre nuk mund t'u ndalen pensionet. Një pjesë e tyre janë edhe themelues të UÇK-së. Nuk guxojmë që ta kërkojmë ndaljen e pensioneve për ata 20 mijë persona, ku në mesin e tyre janë mbi tre mijë veteranë të vërtetë. Prokuroria duhet të kryejë punën e vet dhe të vërtetojë kush ka qenë veteran dhe kush manipulues.

**"Epoka e re":** Prisni që kjo çështje të marrë epilog në një periudhë të shkurtër kohore?

**Gucati:** Nëse liderët politikë e gjejnë një rrugë të përbashkët dhe duan të punojnë për të mirën e vendit dhe të veter-

anëve atëherë sa më shpejt duhet ta zgjidhin këtë çështje. Jemi takuar me presidentin Thaçi dhe presim të takohemi edhe me kryeparlamentarin Veselin dhe kryeministrin Haradinaj, edhe me drejtuesit e tjerë, në mënyrë që njëherë e përgjithmonë ta zgjidhim këtë çështje, pra ta ndajmë shapin prej sheqeri.

**"Epoka e re":** Ju keni deklaruar se për këtë çështje keni marrë mbështetje nga presidenti Thaçi, por si prisni mbështetje edhe nga kryeministri Haradinaj i cili pretendon se kanë qenë mbi 60 mijë veteranë?

**Gucati:** Kemi marrë mbështetje nga presidenti Thaçi, por besojmë shumë edhe në punën dhe në mbështetjen e tij

meqë kryeministri ka qenë komandant i UÇK-së dhe nuk besojmë se ai do të shkelë mbi vlerat e luftës. Duke pasur parasysh se presidenti, kryeparlamentari dhe kryeministri kanë qenë pjesë e UÇK-së, besojmë në mbështetjen e tyre. Unë nuk guxoj të flas me shifra se nuk kam qenë pjesë e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe nuk kam qenë as komandant. Ajo çfarë ka thënë kryeministri Haradinaj le të mbetet në ndërgjegjen e tij. Është e rëndësishme që ai të na mbështesë për ta zgjidhur këtë problem. OVL e UÇK-së kërkon që të bëhet rivlerësimi i veteranëve të luftës. Kërkojmë mbështetjen e të gjithëve në këtë proces sepse është në të mirën tonë dhe në të mirën e të gjithëve.

**"Epoka e re":** Meqë po kërkon mbështetjen e politikës për këtë proces, a do të thotë kjo se politika ka pasur gisht në fryrjen e listave?

**Gucati:** Te fryrja e listave nuk ka faj vetëm hierarkia ushtarake, por edhe politika. Këtë politika nuk mund ta fshehtë. Nuk po dua t'i mbroj komandantët, por politika i ka bërë këto për çështje të votave. Madje këtu politika ka dorë të fortë.

**"Epoka e re":** Duke pasur parasysh ndikimin e madh të politikës, si mund të përmirësohet ky proces?

**Gucati:** Politika e ka prishur, prandaj pikërisht politika duhet ta rregullojë. Kësisoj duhet të prishet ky proces dhe të fillojë një proces i ri. U bëjmë thirrje të gjitha institucioneve për të na

mbështetur që të dalim prej kësaj krize dhe procesi të kthehet në rivlerësim. Në këtë drejtim presim nga Kuvendi miratimin e Ligjit për amnisti.

**"Epoka e re":** Në rast se gjithçka do të shkojë siç ju po kërkon dhe arrini t'i largoni nga lista veteranët e 'rrejshëm', a mund të presim një rebelim të tyre?

**Gucati:** Nuk besoj se janë tranu ata falsat që të dalin në protestë. Së pari duhet me pas ndërgjegje për të dalë në rrugë.

**"Epoka e re":** Po të ishte në pyetje ndërgjegjja nuk do ta merrnin një status që nuk e meritojnë.

**Gucati:** Dihen arsyet pse ata janë futur në lista. Por, nuk besoj se do të kenë ndërgjegje për të dalë dhe për të reaguar në çfarëdo forme.

## GGD-ja organizoi aktivitete me rastin e "Ditës Ndërkombëtare të Fëmijës Vajzë"

PRISHTINË, 11 TETOR (ER) - Në kuadër të projektit "Përfshirja e burrave në atësi" të enjten në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët "Hasan Prishtina" në Prishtinë është shënuar "Dita Ndërkombëtare e Fëmijës Vajzë", e cila synon promovimin e barazisë në çift, prindësinë pozitive dhe marrëdhëniet të shëndetshme përmes parandalimit të dhunës dhe rritjen e fëmijëve mbi idenë e barazisë.

Kryetarja e Grupit të Grave Deputete, Mexhide Mjaku-Topalli, në hapjen e këtij aktiviteti u shpreh e kënaqur që ky aktivitet është duke u mbajtur në objektin e shkollës që mbanë

emrin e personalitetit më të shquar të kombit shqiptar, Hasan Prishtina, i cili, siç tha ajo, konsiderohet mbrojtësi më i spikatur i lirisë, arsimit dhe edukimit të gjuhës shqipe.

Kryetarja Mjaku-Topalli gjatë fjalimit të saj ndau kënaqësinë me të pranishmit me rastin e shënimit të kësaj dite, e cila tanimë është duke u shënuar edhe në Kosovë. Ajo theksoi se duke e lartësuar rolin e vajzës dhe gruas, në arsimin, edukim dhe në të gjitha sferat e tjera të jetës, i kontribuohet vendit me një shoqëri të shëndoshë dhe të dobishme. "Fuqizimi dhe investimi te vajzat është baza e ndërprerjes së

diskriminimit dhe dhunës, është baza e promovimit dhe mbrojtjes së gëzimit të plotë dhe efektiv të të drejtave të tyre. Dita Ndërkombëtare e Vajzave është dita kur grupet e aktivistëve bashkohen me një qëllim: për të theksuar, diskutuar dhe vepruar në drejtim të avancimit të të drejtave dhe mundësive të vajzave, kudo që janë", ka thënë Mjaku-Topalli.

Kryetarja e GGD-së u bëri thirrje grave dhe vajzave që mos ta konsiderojnë apo pranojnë që të jenë faktorë plotësues apo sekundarë në shoqëri apo familje. Ajo ka kërkuar angazhim edhe më të madh dhe vendosmëri. Lidhur



me këtë, ajo ka kërkuar që vajzat dhe gratë të jenë frymëzuese në të gjithë fushat profesionale, në mënyrë që ta rrisin rolin e tyre në shoqëri, në të gjithë lëmenjtë.

Në këtë aktivitet pjesëmarrës ishin bashkëpunëtorë të projektit, përfaqësues të institucioneve, organizatave ndërkombëtare dhe atyre lokale.

## Ministri Bytyqi: Të punojmë së bashku për nxitjen e diversitetit në shkolla



PRISHTINË, 11 TETOR (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, mori pjesë të enjten në konferencën përmblylëse të projektit "Nxitja e kulturës demokratike dhe e diversitetit në shkollë", projekt ky i bashkë-financuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës. Ky projekt është zbatuar në 20 shkolla pilote dhe përgjatë dy vjetëve kanë marrë pjesë rreth 200 përfaqësues, përfshirë drejtorë, mësues, prindër dhe

pjesëmarrës të komuniteteve. Ministri Bytyqi ka falënderuar BE-në dhe Këshillin e Evropës për mbështetjen në këtë projekt që i ka kontribuar rritjes së cilësisë në shkollat tona. "Ky projekt i ka kushtuar një rol të rëndësishëm dhe të veçantë krijimit të një kulture demokratike dhe nxitjen e diversitetit nëpër shkollat tona, një çështje shumë e rëndësishme dhe një përpjekje shumë e madhe edhe e partnerëve tanë, por edhe e MASHT-it, që të kemi shkolla sa më të

zhvilluara", ka thënë ai. Ministri Bytyqi përmendi faktin se në kuadër të këtij projekti është bërë edhe trajnimi i mësuesve, me qëllim të mbështetjes së sistemit arsimor në Kosovë.

"Si rezultat i këtij projekti janë rritur aftësitë e mësuesve trajnerë për të ndihmuar dhe monitoruar proceset demokratike dhe gjithëpërfshirëse në zhvillimin e shkollave", është shprehur ministri Bytyqi, duke theksuar se

tash kur ky projekt po përfundon. "Trajnerët janë të gatshëm për t'u angazhuar në proceset konkrete të zhvillimit të shkollave dhe do ta lehtësojnë zhvillimin e proceseve përmes dhënies së trajnimit në nivel vendor dhe rajonal për ekipet e shkollave të zgjedhura pilot të angazuara ndaj proceseve të zhvillimit profesional. Ky projekt ka nxjerrë në pah që politikën, rregullat dhe praktikën shkollore duhet të hartohen në mënyrë të tillë që ta ndalojnë

dhe ta parandalojnë diskriminimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë", ka thënë ministri Bytyqi.

Ministri ka theksuar edhe rolin e prindërve në këtë proces. Bytyqi ka thënë se prindi duhet të jetë gjithmonë pjesëmarrës për zgjidhjen e këtyre çështjeve pasi, sipas tij, ata janë edukatorët kryesorë të fëmijëve dhe e dinë më së miri se cilat janë kërkesat e fëmijëve të tyre për t'i zgjidhur problemet që paraqiten ndaj diskriminimeve të caktuara.

## Një delegacion i Kuvendit po qëndron në Vjenë

VJENË, 11 TETOR (ER) - Me ftesë të Parlamentit të Republikës së Austrisë, një delegacion nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, i përbërë nga Haxhi Shala, kryetar i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, Elmi Reçica, anëtar i Komisionit për Punë të Jashtme, Glauk Konjufca,

zëvendëskryetar i parë i Komisionit për Punë të Jashtme dhe Rexhep Selimi, zëvendëskryetar i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, po merr pjesë në Konferencën Ndërparlamentare për Politikë të Përbashkët të Jashtme dhe Sigurisë dhe për Politikë të Përbashkët dhe Sigurisë e

Mbrojtjes (CFSP/CSDP), nga data 11 deri 12 tetor 2018, në Vjenë.

Temat e diskutimit në këtë konferencë janë: siguria, migracioni, kontrolli i jashtëm i kufijve, kontributi i BE-së për përmirësimin e situatës politike dhe humanitare në Siri, si dhe perspektiva evropiane për vendet e Ballkanit Perëndimor.





Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Lëvizja Vetëvendosja nuk iu përgjigjën ftesës së kryeparlamentarit Kadri Veseli për të diskutuar rreth draftrezolutës për dialogun me Serbinë

## Dështon përpjekja për unifikimin e pozitës dhe opozitës për dialogun

Ftesës së kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, lidhur me rezolutën e propozuar për dialogun me Serbinë nuk i janë përgjigjur të mërkurën LDK-ja dhe Vetëvendosja, por kësaj ftese i janë përgjigjur përfaqësuesit e Partisë Socialdemokrate dhe të Alternativës. Në këtë takim në të cilin kanë marrë pjesë përfaqësuesit e të gjitha partive shqiptare në pushtet, Veseli ka bërë thirrje për unitet rreth platformës për dialogun me Serbinë

është e ardhmja se çdo kolltuk", ka theksuar Veseli. Ai ka thënë se dikush mund të mendojë se do të përfitojë nga kjo situatë por kështu, sipas tij, dëmtohet Kosova. Veseli ka shtuar se nga kjo situatë varet edhe liberalizimi i vizave dhe shumë procese të tjera integrale. "Është momenti të ulemi bashkërisht dhe ta zgjidhim këtë çështje. Nuk shkon me inat, revoltë e frustrim. Nëse ke probleme të brendshme, ato nuk duhet bartur jashtë", ka deklaruar Veseli. Shefi i grupit parlamentar i Partisë Socialdemokrate, Dardan Sejdiu, i cili ishte pjesë e takimit të thirrur nga kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë se procesi i dialogut me Serbinë nuk mund të ecë pa konsensus. "Ne si PSD do të shkojmë në çdo takim, qoftë i thirrur nga pozita apo opozita. Debatet nuk duhet të bëhen nëpër studio televizive dhe as konferencë për medie, por debati duhet të bëhet në Kuvend", ka thënë Sejdiu. Ndërkaq kryetarja e Alternativës, deputetja Mimoza Kusari-Lila, ka bërë thirrje për një platformë unike për dialogun me Serbinë. Pas takimit që u mbajt në Kuvend, ku temë diskutimi ishte dialogu Kosovë - Serbi, ajo ka pohuar se nëse nuk arrihet unitet në këtë proces, vendi duhet të shkojë në zgjed-

hje të reja. "Kosova duhet të ketë një platformë unike. Nëse s'ka platformë të përbashkët, atëherë duhet të shkojmë në zgjedhje pasi Kosova është e bllokuar", ka thënë Kusari-Lila. Në këtë drejtim ajo ka fajësuar

kryeministrin Ramush Haradinaj pasi, sipas saj, ai është tërhequr nga pozita e tij në këtë proces të dialogut siç ka thënë Kusari-Lila, duke ia lënë në dorë dialogun presidentit Thaçi.

### Hoti: Vetëm zgjedhjet i japin frymë demokracisë

Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka bërë me dije edhe një herë se kjo parti politike nuk do ta përkrahë ndonjë draftrezolutë të mundshme të koalicionit qeverisës për dialogun Kosovë - Serbi. Hoti ka shkruar në llogarinë e vet në "Facebook", se LDK-ja për ta mbrojtur integritetin territorial të Kosovës, ka propozuar rezolutën me të cilën do t'ia vendosin vijat e kuqe dialogut Kosovë - Serbi. Sipas tij, vetëm zgjedhjet i japin frymë demokracisë dhe institucioneve në vend. "Ata që sot po përpjekin të kontrabandojnë veten në

këtë dialog, kanë qenë penguesit kryesorë të përpjekjes sonë për ta mbrojtur shtetin. Të tillët kanë dëshmuar tash e sa kohë se kurdo që ju nevojitet, e vënë në pikëpyetje shtetësinë, pozitën ndërkombëtare dhe territorin e vendit. E kanë filluar më 22 dhjetor të vitit të kaluar, e po vazhdojnë sot e gjithë ditën. Të tillëve jo që nuk duhet votuar rezolutën, por një orë e para duhet larguar nga pushteti. Vetëm zgjedhjet i japin frymë demokracisë dhe institucioneve në vend. Çdo vonesë e bën edhe më të paqartë të ardhmen tonë", ka shkruar Hoti.

EPOKA  
ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 11 TETOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka zhvilluar të enjten një takim me përfaqësues të subjekteve politike lidhur me rezolutën e propozuar për dialogun me Serbinë.

Takimin, në të cilin morën pjesë përfaqësues të partive politike në koalicion, si dhe të dy partive opozitare, Partisë Socialdemokrate dhe të Alternativës, kryeparlamentari Veseli e konsideroi shumë konstruktiv. Duke bërë thirrje për konsensus të përgjithshëm, kreu i Kuvendit ka theksuar se Kosova duhet të ketë me një zë dhe një qëndrim rreth platformës së vet. "U takuam me disa nga kolegët e opozitës në përpjekjen për të ndërtuar një konsensus për integritetin territorial të

Kosovës. Ishte takim shumë konstruktiv. Sot kemi qenë bashkë për ta forcuar pozicionin e Kosovës në dialog", ka thënë Veseli.

Kreu i Kuvendit ka shtuar se ishte pajtim i të gjithëve se duhet të ketë qëndrim për shtet sovran dhe jo asociacion me kompetenca ekzekutive. Kreu i Kuvendit shtoi se rezoluta e propozuar është e hapur, prandaj mund të futet çdo gjë që është e rëndësishme. Ai ka ftuar dy partitë e tjera opozitare, LDK-në dhe LV-në, që të bashkohen për të arritur një konsensus nacional që Kosova të jetë, siç tha ai, më e fortë përballë Serbisë në dialog. "Rezoluta e propozuar përfshin gjithçka që opozita dhe pozita kanë kërkuar. Kam një mesazh për partitë opozitare: nuk mund të jetë Kosova fushëbetejë për pushtet. Më e rëndësishme

### Ambasadorët e Quintit takohen me Veselin

PRISHTINË, 11 TETOR (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës dhe kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, të enjten ka pritur në takim ambasadorët e Quintit, me të cilët ka biseduar për shtimin e përpjekjeve për arritjen e konsensusit për fazën finale të dia-

logut Kosovë - Serbi. Sipas tij, takimi i së enjtes me një pjesë të opozitës ka qenë hap i rëndësishëm në këtë drejtim. "Me ambasadorët e vendeve të Quintit dhe shefen e Zyrës së BE-së në Kosovë, biseduam për nevojën që të bashkohemi, pozitë dhe opozitë, në fazën finale të

dialogut Kosovë - Serbi. Takimi i sotëm, në të cilin me një pjesë të opozitës diskutuam për draftrezolutën për dialogun, ishte një hap i rëndësishëm. Në ditët në vazhdim do t'i shtojmë përpjekjet që konsensusi të ndodhë sa më parë", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".



# KEDS-i fillon digjitalizimin e rrjetit

PRISHTINË, 11 TETOR (ER) - KEDS-i ka filluar digjitalizimin e rrjetit elektrik në Kosovë, monitorimin dhe kontrollimin e rrjetit në mënyrë digjitale. Kjo mundësohet nga sistemi SCADA, i cili operon përmes zyrës qendrore në Prishtinë, e pajisur me teknologjinë e fjalës së fundit. Instalimi i këtij projekti, ku KEDS-i po investon 4 milionë euro, nënkupton se do të ketë më pak ndalesa të energjisë elektrike. Në rast të ndonjë defekti përmes digjitalizimit

parashihet që konsumatorët të mbesin shumë më pak me energji elektrike, pasi sistemi mundëson efikasitet të madh, duke e shkurtuar shumë kohën e intervenimit. "Nga kompjuterët, tabletët apo telefonat mobilë mund të shikohet operimi komplet i rrjetit dhe të intervenohet nëse paraqitet ndonjë domosdoshmëri. Këtu përfshihen edhe ndalesat eventuale në rast të ndonjë të papritur apo anomalie të shkaktuar nga faktorët e jashtëm", është thënë në

njoftimin e KEDS-it. Projekti fillimisht ka nisur në 20 nënstacione anekënd Kosovës, për t'u shpërndarë në një periudhë sa më të shkurtër kohore në të gjithë rrjetin elektrik. "Me SCADA-n nis digjitalizimi i rrjetit elektrik në Kosovë. Kjo tregon përkushtimin dhe qasjen e KEDS-it që përmes investimeve të fjalës së fundit të teknologjisë, të përfitojnë sa më tepër konsumatorët kosovarë", është bërë me dije në njoftimin e KEDS-it.



# Çmimet e konsumit shënuan rritje

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 11 TETOR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar "Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit" (IHÇK) për muajin shtator të vitit 2018. Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit prej muajit janar 2016 publikohet me vitin bazë 2015=100. Inflacioni mujor i matur në shtator 2018 nga indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit ishte 0.1 për qind. Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë për 0.1 për qind në muajin shtator 2018, krahasuar me muajin gusht 2018. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit të nëngrupet e COICOP-it: bukë dhe drithëra (1.5 për qind); perime (2.5 për qind); veshje (1.9 për qind), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0.4 për qind në IHÇK. Ngritja u neutralizua kryesisht



nga rënia e çmimeve të konsumit të nëngrupet e COICOP-it: pemë (-7.6 për qind); shërbime për transport (-5.3 për qind) (rënie e çmimeve të bile-

tave të transportit ajror); pushime të organizuara (-4.4 për qind), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej (-0.3 për qind) në

IHÇK. Ndërsa shkalla vjetore e inflacionit ishte 1.4 për qind. Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë për 1.4 për qind

në muajin shtator 2018, krahasuar me muajin shtator të vitit 2017. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë të nëngrupet e COICOP-it: bukë dhe drithëra (2.1 për qind); mish (3.1 për qind); qumësht, djathë dhe vezë (3.4 për qind); perime (13.0 për qind); duhan (2.9 për qind); përdorim të pajisjeve për transportin personal (10.6 për qind) (ngritje e çmimit të naftës dhe benzinës); shërbime hoteliere (3.2 për qind), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 2.1 përqindësh në IHÇK.

Ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e çmimeve të konsumit të nëngrupet e COICOP-it: pemë (-6.7 për qind); sheqer dhe ëmbëlsira (-7.7 për qind); energji elektrike, gaz dhe lëndë djegëse të tjera (-7.0 për qind); pajisje audio-vizuale, fotografike për përpunimin e informatave (-3.8 për qind), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej (-0.7 për qind) në IHÇK.

# MTI-ja ofron partneritet për adresimin e sfidave të sektorit privat

PRISHTINË, 11 TETOR (ER) - Komuniteti i biznesit duhet të përfshihet qysh në fazat e hershme të procesit të hartimit të legjislacionit që ka ndikim në sektorin privat, në mënyrë që të sigurohet që legjislacioni është në përputhje me nevojat e industrisë dhe nxit zhvillimin ekonomik në vend. Ky ishte konkludimi kryesor i tryezës së Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, ku bizneset patën mundësinë të diskutojnë të enjten me ministrin e Tregtisë dhe Industrisë në Kosovë, Endrit Shala. Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, i ka uruar mirëseardhje ministrit të ri, duke potencuar që kjo ministri

është e një rëndësie tejet të veçantë për të gjitha bizneset në vend, marrë parasysh numrin e madh të fushave të cilat i mbulon, nisur nga konkurrenca, mbrojtja e konsumatorit e deri tek pronësia industriale. Ai ka shprehur gatishmërinë e Odës Amerikane për ta dhënë kontributin e saj në të gjitha fushat me ndikim në mjedisin afarist në vend.

Ilir Ibrahim, president i Bordit të Governorëve të Odës Amerikane, ka theksuar rëndësinë e pasjes së një dialogu të mirëfilltë dhe konstruktiv mes sektorit privat dhe atij publik, si e vetmja mënyrë për ta garantuar rritjen e sektorit privat në vend. Në këtë drejtim, Ibrahim ka sqaruar se Oda




Amerikane përfaqëson biznese që vijnë nga sektorë të ndryshëm të ekonomisë, duke rezultuar gjithnjë në kërkesa të

balancuara dhe të arsyeshme drejtuar institucioneve. Ndërkaq ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka

folur në pika të shkurtra për disa nga prioritetet e ministrisë që ndërlihen drejtpërdrejt me sektorin privat në vend, duke potencuar se Odën Amerikane e shih si partnere shumë konstruktive. Në mesin e iniciativave të ministrisë, Shala ka thënë se rëndësi të veçantë duhet t'i kushtohet rregullimit të tregut të naftës, si dhe iniciativave për mbrojtjen e konsumatorit. Po ashtu, ai ka bërë me dije se gjatë ditëve të ardhshme do ta ketë mundësinë t'i adresojë sfidat në marrëdhëniet tregtare me homologun e tij në Republikën e Shqipërisë, në mënyrë që t'i hapet rruga e rritjes së tregtisë dhe bashkëpunimit mes dyja vendeve.



# Punimet për Termocentralin 'Kosova e Re' do të fillojnë vitin e ardhshëm



Qeveria e Kosovës dhe kompania fituese për ndërtimin e Termocentralit "Kosova e Re", "Contour Global", nuk do të zbrapsen nga realizimi i projektit, pavarësisht prej deklaratave të përfaqësuesve të Bankës Botërore se nuk do ta mbështesin ndërtimin e një termocentrali të ri me thëngjill

**EPOKA ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 11 TETOR - Ndërtimi i Termocentralit "Kosova e Re" do të nisë në pjesën e parë të vitit të ardhshëm, ka njoftuar të enjten Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZhE). Sipas kësaj ministrie, procesi është në fazën finale të përzgjedhjes së kompanisë për ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Termocentralit.

Kreu i MZhE-së, Valmir Lluka, ka thënë nuk do të bëjnë kompromise në dëm të sigurisë shtetërore të furnizimit me energji elektrike. "Si ministër i këtij vendi, përgjegjës për energji, nuk do ta lejoj që

Kosova të varet nga importet e energjisë. Strategjia e vendit është që rritja ekonomike dhe punësimi të ndodhin në vend duke shfrytëzuar potencialet e jashtëzakonshme vendore për gjenerim të energjisë jo vetëm për nevoja tona, por edhe për eksport. Ne duhet të sigurojmë pavarësi energjetike dhe nuk ka alternativë tjetër, ashtu siç nuk kemi alternativa të tjera për gjenerim të energjisë elektrike", ka thënë ministri Lluka.

Në komunikatën e MZhE-së thuhet se Qeveria e Kosovës është e përkushtuar t'i ndjekë dhe realizojë politikën e saj zhvillimore dhe ekonomike. "Duke u bazuar në Strategjinë e Energjisë së Kosovës 2017-2026,

si dhe në Strategjinë e Zhvillimit Kombëtar, Kosova ka nevojë për kapacitete të reja gjeneruese të energjisë elektrike. Andaj, ne jemi të obliguar t'i realizojmë dhe materializojmë strategjitë e vendit tonë për t'i ofruar vendit, ekonomisë dhe popullit të Kosovës prosperitet dhe siguri në të gjitha fushat. Një ndër projektet më të rëndësishme të Kosovës është Termocentrali "Kosova e Re", thuhet në komunikatën për media. Sipas MZhE-së, projekti ka mbështetje të madhe dhe të pakursyer të partnerëve strategjikë ndërkombëtarë. "Projekti do të finalizohet duke i ndjekur dhe përbushur të gjitha rregullat dhe direktivat ndërkombëtare. 'Kosova e Re' do të finalizohet sepse është e vetmja zgjidhje për ta arritur sigurinë e furnizimit me energji, që ndikon në sigurinë kombëtare të vendit. Në të njëjtën kohë ne po vazhdojmë avancimin e projekteve alternative nga burimet e ripërtëritshme, por nuk mund dhe as nuk guxojmë të eksperimentojmë me sigurinë e vendit", është theksuar në komu-

nikatën e MZhE-së.

Projekti TC "Kosova e Re" është projekti për të cilin janë bërë më së shumti studime dhe secili opsion e nxjerrë TC "Kosova e Re" si zgjidhje të domosdoshme. "Kosova, si shumë palë të tjera kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, ka orientuar politikën e veta afatmesme të sigurimit të furnizimit me energji në rezervat e linjitet. Të njëjtin orientim e kanë edhe vende të tjera të Bashkimit Evropian. Termocentrale të tilla me kapacitete edhe më të mëdha se Kosova e Re sot operojnë, apo edhe janë në fazë të projektimit ose ndërtimit në shumë vende të BE-së, siç është Gjermania, Çekia, Mbretëria e Bashkuar, Italia, Polonia, Rumania, Bullgaria etj. Edhe fqinjët tanë, Serbia, Mali i Zi dhe Bosnje e Hercegovina, po ndërtojnë termocentrale nga linjitet", është bërë me dije në komunikatën e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

Investitori "Contour Global" ka njoftuar Qeverinë e Kosovës se është në rrugë të drejtë të sig-

urimit të financimit të këtij projekti nga institucionet financiare ndërkombëtare. Procesi është në fazën finale të përzgjedhjes së kompanisë për ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Termocentralit. Sipas planifikimeve, ndërtimi i Termocentralit "Kosova e Re" nis në pjesën e parë të vitit të ardhshëm.

Të mërkurën presidenti i Grupit të Bankës Botërore, Jim Yong Kim, ka bërë me dije se Banka Botërore nuk do ta mbështesë ndërtimin e termocentralit "Kosova e Re" në Kosovë. Kimi e ka bërë të qartë qëndrimin e Bankës Botërore rreth termocentralit 1.3 miliard euro kur u pyet nga Visar Azemi, drejtor ekzekutiv i "Balkan Green", në takimet vjetore të Grupit të Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar që po zhvillohen në Bali të Indonezisë. "Në kërkohet me aktet tona nënligjore t'i ndjekim opsionet me kosto më të ulët, meqë burimet alternative tani janë nën koston e qymyrit. Nuk do ta mbështesim një projekt të tillë", ka thënë Kimi.

## Prizren, 27 aktakuza për uzurpim prone të Hekurudhës

Prizren, 11 tetor (ER) - Prokuroria Themelore në Prizren ka ngritur 27 aktakuza kundër 27 personave për rastet e uzurpimit të pronës së Hekurudhës në Komunën e Prizrenit. Prokuroria Themelore në Prizren, pas pranimit të 51 kallëzimeve penale nga Kompania për Menaxhim të Infrastrukturës Hekurudhore - "Infrakos Sh. A", ka trajtuar dhe hetuar të gjitha këto kallëzime penale dhe, pas koordinimit të veprimeve të nevojshme hetimore, ka ngritur 27 aktakuza kundër 27 personave për veprat penale: "Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme" nga neni 332, paragrafi 2 dhe "Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë", neni 333, paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Nga të gjitha lëndët e pranuar, në gjashtë prej tyre janë hedhur kallëzimet penale, ndërsa 18 lëndë janë ende në punë, për të cilat Prokuroria në Prizren është duke ndërmarrë veprimet e nevojshme hetimore. Gjithashtu, Departamenti për

Krime të Rënda ka marrë aktvendim për fillimin e hetimeve për 13 persona për shkak të dyshimit të arsyeshëm se kanë kryer veprën penale "Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar" nga neni 422, paragrafi 1 i Kodit Penal, si dhe për veprat penale "Punimet ndërtimore të kundërligjshme" nga neni 368, paragrafi 1 dhe "Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme" nga neni 332 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, lidhur me lëshimin e lejeve ndërtimore në afërsi të pronës së Hekurudhës, duke mos respektuar distancën e duhur nga binarët, sipas Ligjit për Hekurudhat e Kosovës.



## Dorëzohen në Kushtetuese dosjet e padive për kompensimin e dëmeve të luftës

PRISHTINË, 11 TETOR - Shoqata "Ngritja e Zërit" ka dorëzuar të enjten dosjet e radhës në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës rreth vlerësimit të kushtetutshmërisë së aktit juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës me rastin e refuzimit të padive për kompensimin e

dëmeve të luftës.

Kryetari i kësaj shoqate, Jahir Bejta, ka thënë se edhe pse për gjykimin e çështjeve juridike kompetente janë gjykatat në vendet e të cilave kanë ndodhur krimet, një gjë e tillë nuk po bëhet në Kosovë. Bejta i bëri thirrje Ministrisë së

Drejtësisë që në agjendën për vitin 2020 ta fusin edhe zhblokimin e gjykatave. Shoqata "Ngritja e Zërit" në korrik të vitit kishte dorëzuar dosje të ngjashme mirëpo, sipas kryetarit të kësaj shoqate, nuk kanë marrë ndonjë përgjigje deri më tani.



## Nis ndërtimi i kolektorit verior për trajtimin e ujërave të zeza në Papaz të Ferizajt

FERIZAJ, 11 TETOR - (ER) Kanë nisur punimet për ndërtimin e kolektorit verior për trajtimin e ujërave të zeza në fshatin Papaz të Ferizajt. Për t'i parë këto punime doli edhe kryetari i Ferizajt, Agim Aliu, bashkë me drejtorin e Infrastrukturës, Arbër Bytyqi. Aliu ka vlerësuar se Ferizaj ka përmbyllur kapitullin e investimeve kapitale të natyrës nëntokësore.

Madje shtoi se me ndërtimin e impiantit të trajtimit të ujërave të zeza, zotim ky i dhënë nga ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Llluka, gjatë vizitës së tij në Ferizaj përmbyllet edhe kapitulli i trajtimit të ujërave të zeza. "E para që dua të them është se Ferizaj ka përmbyllur dhe po përmbyll, përveç disa rasteve që janë tepër minore, investimet kapitale të

natyrës nëntokësore, në mënyrë të veçantë të kanalizimeve dhe sigurisht se hap një kapitull të re dhe këtu jemi në një projekt që hap këtë kapitull, kapitullin e përmbylljes së trajtimit të ujërave të zeza", ka thënë Aliu. Ky projekt kap vlerën e 1 milion e 300 mijë eurove dhe ka një gjatësi afërsisht prej 13 kilometrash dhe përfshin një grup të madh fshattrash.

## Në Malishevë do të ndërtohen 40 banesa për rastet sociale

Ky projekt do të kushtojë rreth 650 mijë euro dhe bashkëfinancohet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Komunës së Malishevës.

MALISHEVË, 11 TETOR (ER) - Të enjten është nënshkruar kontrata për ndërtimin e qendrës së banimit social në Malishevë, që planifikohet t'i ketë 40 banesa për rastet sociale që kanë problem strehimin. Kjo marrëveshje u nënshkrua nga Komuna e Malishevës dhe operatori N. N. "Themeli". "Për mua është një moment shumë i rëndësishëm, pasi tashmë janë kryer të gjitha procedurat dhe sot po e nënshkruajmë këtë kontratë për ndërtimin e qendrës së banimit social, një prej projekteve më të mëdha

për këtë vit dhe përfundimisht do të kemi mundësi të sigurojmë banim për 40 familje në nevojë", ka thënë nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha.

Ky projekt do të kushtojë rreth 650 mijë euro dhe bashkëfinancohet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Komunës së Malishevës. Bazuar në kontratën e nënshkruar, ky projekt është dyvjeçar, ndërsa punimet pritet të fillojnë nga java e ardhshme, varësisht prej kushteve atmosferike.



## Përkujtohet ish-deputeti Ramadan Kelmendi

MITROVICË, 11 TETOR (ER) - Nën organizim të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe "RTV Mitrovica" është mbajtur të enjten akademi përkujtimore me rastin e pesëvjetorit të vdekjes së ish-deputetit të Kuvendit të Kosovës, Ramadan Kelmendi. Në këtë akademi morën pjesë kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, deputetë të Kuvendit të Kosovës, familjarë të të ndjerit

Kelmendi, bashkëveprimtarë dhe shumë qytetarë të Mitrovicës, rajonit e më gjerë. Duke folur i pari në akademinë përkujtuuese, kryetari i Komunës, Agim Bahtiri, ka thënë se vdekja e Ramadan Kelmendit ka qenë një lajm i rëndë dhe i dhembshëm, veprimtarit të shquar të çështjes kombëtare, ish-deputetit të Kuvendit të Kosovës, humanistit të madh dhe liridashësit Ramadan Kelmendi, ua lëkundim zemrat të gjithëve.

Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka vlerësuar lart figurën e Ramadan Kelmendit dhe kontributin e tij dhënë, gjatë dhe pas luftës së fundit në Kosovë. Në emër të familjes të pranishmit i përshëndeti Fitnete Kelmendi, vajza e ish-deputetit të Kuvendit të Kosovës, Ramadan Kelmendi, duke thënë se veprat e babait të saj janë udhëzues të rrugës së saj dhe gjithsecilit që e njohën ish-deputetin Ramadan Kelmendi.



## Vlerësohet e qëndrueshme situata e sigurisë në Mitrovicë

MITROVICË, 11 TETOR (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, ka vizituar të enjten Komunën e Mitrovicës, ku është pritur nga kryetari i komunës, Agim Bahtiri, me ç'rast kanë biseduar për situatën e përgjithshme në komunë, me theks të posaçëm për atë të sigurisë.

Kryetari i Komunës, Agim Bahtiri, pasi e ka falënderuar ministrin Gashi për vizitën dhe për interesimin e tij të vazhdueshëm për Mitrovicën, ka bërë me dije se falë maturisë dhe përkushtimit të qytetarëve, angazhimit maksimal të strukturave dhe institucioneve komunale dhe bashkëpunimit të mirë e të suksesshëm me

organet e rendit, situata e sigurisë në komunë është e qetë. Në vazhdim kryetari Bahtiri e njoftoi ministrin Gashi lidhur me projektin e BE-së për rehabilitimin e urës kryesore mbi lumin Ibër, për të cilin tha se ai në cepin jugor të urës është kryer para më shumë se një viti, ndërsa që para disa ditësh ka përfunduar edhe në cepin verior të urës.

Ministri Bejtush Gashi ka thënë se Ministria e Punëve të Brendshme do t'i mbështesë qytetarët e Komunës së Mitrovicës dhe udhëheqjen e saj maksimalisht për të mbajtur këtë trend pozitiv dhe për të krijuar një ambient më të sigurt për të gjithë qytetarët. "Më vjen mirë që po dëgjoj nga




ju kryetar Bahtiri për përkushtimin tuaj për rihapjen e urës kryesore mbi Ibër dhe që të gjitha problemet të zgjidhen me

dialog e në mënyrë paqësore. Kjo është e vetmja rrugë që garanton që rendi dhe qetësia publike në qytetin e Mitrovicës të jenë në

nivelin e kërkuar dhe që ambienti i përgjithshëm këtu të jetë i sigurt dhe pa probleme e incidente", ka thënë Gashi.

## Prokuroria dhe Policia e Pejës koordinohen për luftimin e drogës dhe korrupsionit



PEJË, 11 TETOR (ER) - Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore të Pejës, Agim Kurmehaj, ka mbajtur të enjten takime të ndara me udhëheqësit e tri njësiteve hetimore të Policisë së Kosovës, përkatësisht me Njësitin për Hetimin e Trafikimit të Drogës, qenieve njerëzore dhe atë të Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit. Gjatë këtyre takimeve me het-

uesit policorë u bashkëbisedua për rezultatet e deritanishme, për nivelin e krimit nën kompetencën territoriale të kësaj prokurorie dhe shtimin e veprimeve dhe mënyrave të bashkëpunimit, duke ndërtuar strategji konkrete me qëllim të luftimit të kriminalitetit. "Inkurajohen të gjithë qytetarët të cilët kanë informata për kryesit e këtyre veprave

penale që të njëjtët t'i raportojnë te Policia e Kosovës, ose te prokurorët kujdestarë. Takime të kësaj natyre do mbahen edhe pas dy jave për t'i vlerësuar dhe koordinuar veprimet e mëtejshme për luftimin e këtyre dukurive negative që shqetësojnë shoqërinë tonë", është thënë në njoftimin e Prokurorisë Themelore të Pejës.

## Nisin punimet për asfaltimin e rrugës në Kërvasari të Malishevës

MALISHEVË, 11 TETOR (ER) - Në fshatin Kërvasari të Malishevës kanë nisur punimet për rregullimin e rrugës e cila lidh një lagje të fshatit me rrugën kryesore. Punimet në këtë rrugë të enjten i kanë inspektuar nënkryetari i Malishevës,

Hajdin Berisha dhe drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, Islam Vrenezi. "Rregullimi i kësaj rruge ka rëndësi të madhe për banorët e kësaj lagje në Kërvasari, kurse punimet janë duke u zhvilluar mirë dhe banorët janë shprehur shumë të

kënaqur. I kënaqur me ecurinë e punimeve është ndarë edhe nënkryetari Berisha, ndërsa i ka uruar banorët për këtë rrugë e cila do t'ua lehtësojë lëvizjen e tyre", është bërë me dije në njoftimin e Komunës së Malishevës.



## Sigurimi i Trumpit në Britani ka kushtuar rreth 24 milionë dollarë



LONDËR, 11 TETOR - Shefat e Policisë britanike kanë thënë se për të siguruar presidentin amerikan, Donald Trump gjatë vizitës së tij në Britani të Madhe në muajin korrik kanë angazhuar pothuajse 10,000 zyrtarë policorë, çka ka kushtuar rreth 24 milionë dollarë, duke realizuar kështu operacionin

më të madh policor në këtë shtet nga viti 2011, transmeton AP. Drejtorja e Këshillit të Shefave të Policisë Kombëtare, Sara Thornton ka thënë të enjten se gati secili polic është angazhuar për të mbuluar vizitën katërditore të presidentit Trump. Ajo ka thënë se "shpenzimet e opera-

cionit janë ende duke u analizuar mirëpo vlera e përafërt është 24 milionë dollarë". Gjatë kësaj vizite, Trumpi ishte takuar me kryeministren britanike, Theresa May, Mbretëreshën Elizabeta II dhe kishte vizituar një klub golfi në Skoci. Vizita e Trumpit në Britani ishte përcjell me protesta të mëdha kundër tij.

## Vizita e Papa Françeskut në Korenë Veriore, ëndërr e realizueshme

Zyra Presidenciale e Koresë Jugore ka thënë se lideri i Koresë Veriore i ka shprehur presidentit jugkorean dëshirën që Papa ta vizitojë Phenjanin, në samitin që kanë zhvilluar dy liderët muajin e kaluar



e kaluar. Asnjë papë nuk ka vizituar ndonjëherë Korenë Veriore, ndonëse Papa Gjon Pali II është ftuar një

herë. Në vitin 2000, babai i liderit verikorean, Kim Jong-il ka ftuar Papa Gjon Palin II të vizitojë Korenë Jugore, duke thënë se do

të ishte "mrekulli" nëse ai do të vizitonte këtë shtet. Papa Françesku pritet ta vizitojë Japoninë vitin e ardhshëm.


VATIKAN, 11 TETOR - Një udhëtim i Papa Françeskut në Korenë Veriore është "ëndërr që mund të realizohet" dhe do të ishte një hap gjigant në rrugën drejt paqes në Gadishullin Korean, ka thënë peshkopi jugkorean Lazarus You Heung-sik.

Heung-sik ka folur para zhvillimit të takimit në javën e ardhshme në Vatikan në mes të Papa Françeskut dhe presidentit jugkorean, Moon Jae-in, i cili do të ketë me vete ftesën e liderit verikorean, Kim Jong Un drejtuar Papës, për të vizituar Phenjanin. "Nëse Papa shkon atje, do të ishte hap i madh, hap kualitativ

për Gadishullin Korean dhe paqen në këtë vend", ka thënë peshkopi, i cili ka qenë pjesëmarrës në një takim në Romë, së bashku me peshkopë tjerë në botë. "Koreja Veriore mund t'i bashkohet komunitetit botëror si shtet normal. E di sa shumë ka bërë thirrje Papa për paqe në Gadishullin Korean në shumë organizime", ka thënë ndër të tjera ai.

Zyra Presidenciale e Koresë Jugore ka thënë se lideri verikorean i ka shprehur presidentit jugkorean dëshirën që Papa të vizitojë Phenjanin, në samitin që kanë zhvilluar dy liderët muajin

## Pretendimet amerikane për spiunazh të fabrikuar



PEKIN, 11 TETOR - Ministria e Jashtme e Kinës mohon akuzat se një zyrtar kinez është kapur duke u përpjekur të tregojë sekrete nga aviacioni i ShBA-së dhe kompanive hapësinore për llogari të Kinës dhe sipas saj, ato janë shpifje. "Shpresojmë që ShBA-ja t'i respektojë të drejtat dhe interesat legjitime të qytetarit kinez", theksoi zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme kineze, Lu Kang. Një zyrtar kinez i rangut të lartë është arrestuar me dyshimin për spiunazh ekonomik kundër disa

kompanive të aviacionit dhe të hapësirës ajrore të ShBA-së, sipas një deklaratë të Departamentit të Drejtësisë të ShBA-së. Yanjun Xu, zëvendës drejtor i Departamentit të Sigurisë në Jiangsu, është akuzuar për spiunazh ekonomik dhe përpjekjet për t'i nxjerrë sekretet tregtare nga kompanitë duke përfshirë GE Aviation, degë e General Electric. "Xu u arrestua në Belgjikë më 1 prill", sipas deklaratës. Ndihmësprokurori i Përgjithshëm, John Demers tha se rastit nuk ishte

një incident i izoluar. "Ne nuk mund ta tolerojmë një komb duke vjedhur fuqinë e zjarrit dhe frytet e fuqisë sonë të trurit. Nuk mund të tolerojmë një komb që vjedh atë që nuk mbjell", theksoi ai. GE prodhon motorë për avionë dhe turboprop, si dhe pjesë për avionë ushtarakë, biznesesh dhe komerciale. Gjithashtu po punon për gjeneratën e ardhshme në motorë për avionë komerciale dhe helikopterë ushtarakë. Xu do të gjykohe në një gjykatë federale në Cincinnati, Ohio.

## Uragani Majkëll dëmton rëndë juglindjen e ShBA-së

WASHINGTON, 11 TETOR - I konsideruar si një nga uraganet më të fuqishme në historinë e Shteteve të Bashkuara, Majkëll ka arritur në veriperëndim të Floridas, duke vërsuar shtëpitë dhe duke nxjerrë rrënjët e drunjve jashtë tokës. Shërbimet e shpëtimit janë duke pritur që të bëhet ditë për të kuptuar plotësisht dëmet e Uraganit Majkëll, i cili u është afuar brigjeve të Floridas të mërkurën në mbrëmje me fuqi të erës deri në 250 kilometra në

orë. Dy persona, përfshirë një fëmijë, kanë vdekur si pasojë e këtij Uragani. Ndonëse është dobësuar nga kategoria e katërt sa ka qenë në fillim, Majkëll është nisur drejt Karolinës. Qendra Kombëtare për Stuhi ka njoftuar se paralajmërimet për stuhi janë vënë duke nisur nga plazhet e Panamasë e deri te Karolina Veriore. Autoritetet janë të shqetësuara se personat që kanë injoruar thirrjet për evakuim mund të jenë përmbly-

tur në disa zona. Qindra mija shtëpia dhe biznese kanë mbetur pa energji elektrike në Florida, Alabama dhe Xhorxhia. Majkëll është cilësuar në mesin e uraganeve më të fuqishme që ka goditur SHBA-në duke marrë parasysh fuqinë e erës dhe presionin në barometër dhe është krahasuar me Uraganin Andru më 1992. Ndonëse fuqia e Uraganit Majkëll është zvogëluar, një rritje e shpejtë e tij mund të jetë e befasishme.





# POPULLI SHQIPTAR NË MAQEDONI



**Ismet SYLEJMANI**

Populli shqiptar në Maqedoni, me qëndresën titanike dhe mosnënshtrimin para makinerisë shfarosëse në ish - jugosllavi dhe pas luftës heroike të UÇK-së të vitit 2001, po tregon qartë para botës se është i vendosur për të ecur përpara e për të shënuar suksese të pandërprera, të cilat patjetër se do të vlerësohen e mirëprehen jo vetëm nga NATO e BE por edhe nga mekanizma të tjerë relevant ndërkombëtarë!

Referendumi i 30 shtatorit në Maqedoni, për hyrje në NATO dhe BE, dëshmoi se populli shqiptar është bërë zot i fateve të veta në këtë shtet!

Ky është një tregues i madh se kohërat kanë ndryshuar, dhe ndryshimi është cilësor dhe në favor të madh të popullit shqiptar!

Populli shqiptar në Maqedoni jo vetm është bërë zot i fateve të veta dhe po vendos për të ardhmen e tij, por po dëshmon e po tregon para botës se në proceset integruese është vendimtar e me rol të madh aktiv e progresiv, se kalkulimet në Maqedoni pa të jo vetem janë pa vlerë e të gabuara, por edhe të destinuar të dështojnë me turp e fiasko!

Këtë si asnjëherë më parë, populli shqiptar në Maqedoni e tregoi edhe në referendumin e 30 shtatorit, për në NATO e në BE! Populli shqiptar e ka të qartë

sikur diellin që e shohim kur ai shkëlqen e rrezaton fuqishëm mbi planet, se në tokat e tij shqiptare në Maqedoni është e do të jetë zot i fateve të veta!

Edhe pse referendumi për hyrje në NATO dhe BE të Maqedonisë nuk fitoi me kriteret e rregulla të njohura të përmbylljes së proqeseve, një gjë u vërtetua, se iku njëherë e përgjithmonë koha e vjetër, kur popullit shqiptar në Maqedoni jo vetëm nuk i jepej rasti të deklarohet për asgjë vendimtare, por edhe injorohej për çdo gjë nga regjimi titist e deri në epokën e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare!

230.000 pjestarët e popullit shqiptar të dalur për të votuar në referendum pro hyrjes në NATO dhe BE, janë treguesi i madh dhe dëshmia e qartë se rruga për në NATO e Europë dhe mekanizma të tjerë relevant ndërkombëtar pro euroatlantik

e Maqedonisë është e pakthyeshme!

230.000 shqiptarët që ia dhanë votën NATO-s që bombardoi Serbinë pushtuese, që e djegu nga ajri qerdhen e propagandës atishqiptare Tanjug, Shtabin e Përgjithshëm në Dedinje, fabrikën e municionit dhe armatimit në Kragujevac, ngrohëtoren e Beogradit kryeqytetit serb e goditje të tjera nevralgjike, janë dëshmi e dashurisë së madhe dhe mirënjohjes historike për këtë mekanizëm gjigant ndaj të cilit ka e do të ketë populli shqiptar jo vetëm në Maqedoni por kudo që jeton e vepron!

Është e sigurtë se jeta e mirë, me integritet e nderim, pas luftës së UÇK-së dhe nën udhëheqjen e udhëheqesit të popullit shqiptar e kryetarit të BDI-së Ali Ahmeti, do të vazhdojë gjithnjë e do të shkojë duke u rritur, sepse rruga e popullit shqiptar është ajo që

të shpie drejt kampit të madh e të nderuar të demokracisë botërore në krye me SHBA-të, e kundër bllokut të zi të vrasjeve e të krimeve, të drogës e të prostitucionit, të luftërave e terrorit për të dominuar në planet në garën për të sunduar popujt e shtypur e shtetet pa mbrojtje e të mbetura në shtartin e tmerrshëm të obskurantizmit jo vetëm fetar! Shqiptarët e ardhshëm jo vetëm në Maqedoni por edhe në pjesët tjera, do të tregojnë e do të japin prova të sigurta se do të dijnë të rreshtohen pro frymës së ruajtjes së qyteterimit europian e pro koalicionit antifashist, pro NATO-s e BE-së, sepse kjo është dëshira e të parëve tanë që të ecim në këtë rrugë euroatlantike!

Rroftë populli shqiptar!

Prishtinë, 11 tetor 2018!

E jashtëzakonshme

## Kroati humbet kuletën në Sarandë, shqiptari i kthen atë përmes postës

Një person nga Kroacia kishte ardhur gjatë verës së këtij viti në bregdetin shqiptar për t'i kaluar pushimet verore. Mirëpo gjatë kohës sa kishte qëndruar në bregdetin e Sarandës ai kishte humbur kuletën e tij me para dhe dokumente në të. Pas disa ditësh kuleta i



kishte ardhur në adresën e tij me anë të postës me të gjitha gjërat e vlefshme brenda saj, pasi atë e nisi drejt tij shqiptari Albano Koka.

FOTO E DITES



Një grua qëndron në urën për këmbësorë të lumit Garry pranë Pitlochry në Skoci, e rrethuar me ngjyrat magjike të vjeshtës

E rrallë

## Hapet restoranti ku mund të paguash me numrin e ndjekësve në "Instagram"

Milano do ta ketë restorantin ku mund të paguash me numrin e ndjekësve në "Instagram". "Ju keni kaç shumë ndjekës në 'Instagram'? Ne ju ofrojmë drekë", është slogani



i këtij lokali. Ideja u lind nga dy vëllezërit, Matteo dhe Tommaso Pittarello, pronarë të "This is not a sushi bar".

## BARSOLETA E DITËS



- Pse bre nuk jep shenjë kur të kthehesh në të majtë apo në të djathtë?  
- Biondina: Sepse nuk ka nevojë askujt t'i interesoje kah po shkoj unë.




### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

#### "ALPHA" 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson  
Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

#### "JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN"

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.  
Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

#### "NIGHT SCHOOL"

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.  
Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

#### "SIBERIA",

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.  
Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

#### "VENOM" 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.  
Regjia: Ruben Fleischer  
Based on the Marvel Comics



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



**DASHI**

Koha dhe përkushtimi që duhet t'i dedikoni


vetes sot duhet të jetë ekskluziv dhe të mos ngatërrohet me problemet e personave të tjerë.



**DEMI**

Po përpiqeni të jeni më korrekt seç

duhet dhe doni t'i evitoni gabimet, por nëse nuk gaboni nuk keni për të mësuar asnjëherë nga gabimet tuaja.



**BINJAKËT**

Mundësitë që do t'ju ofrohen sot do t'jua

japin kënaqësinë të përmirësimit mjaft gjëra tuajat që kishin ngërçe të mëdha dhe donin korrigjime.



**GAFORRJA**

Sot dita juaj do të nisë herët sepse

duhet të zgjoheni që në orët e para të mëngjesit. Kjo do t'ju japë shumë energji për ta përballuar ditën.



**LUANI**

Nëse jeni të lidhur nga një marrëdhënie

pune me persona të caktuar duhet të toleroni edhe sjellje që në jetën e përditshme nuk ju pëlqejnë.



**VIRGJËRËSHA**

Keni marrë masa dhe keni

larguar nga vetja këdo që nuk ju ka pëlqyer. Në një moment të caktuar do të kuptoni që i keni larguar të gjithë.



**PESHORJA**

Sot as nuk duhet të merrni parasysh

komentet e personave që i njihni pak dhe kanë një karakter dyshues që nuk përçon asgjë.



**AKREPI**

Nëse doni t'i ngjasoni dikujt që ju e

pëlqeni mundohuni të merrni anët më të mira të tij dhe jo ta imitoni duke dalë nga vetja.



**SHIGJETARI**

Keni besuar dhe keni mbështetur

persona që tashmë ka ardhur momenti t'jua kthejnë mbrapsht gjithë besimin tuaj. Dita do të jetë e shkëlqyer.



**BRICJAPI**

Keni shumë mundësi për të

kaluar mirë ditën sot, por asnjëra prej tyre nuk do t'ju çojë në vendin që do të donit të ishit dhe me personin që do të donit.



**UJORI**

Edhe pse keni ndryshuar shumë

gjatë kësaj kohe persona të caktuar nuk duan ta pranojnë këtë gjë. Do të vazhdojnë të venë në dukje defektet tuaja.



**PESHQIT**

Duhet të jeni koherent me të

tjerët, por aq më shumë me veten tuaj. Nëse keni bërë një premtim duhet ta mbani pavarësisht prej rrethanave.

## Gigi Hadidi shfaqet me veshje transparente në ditëlindjen e motrës së saj



**S**upermodeluesja Gigi Hadid është shfaqur tejet seksi gjatë ditëlindjes së motrës së saj, Bella Hadid, e cila të mërkurën mbushi 22 vjet. Hadid u

shfaq me një bluzë të zezë transparente që i zbulonte reçipetat. 22-vjeçarja është parë duke e mbajtur një dhuratë në dorë të cilën ia ka blerë motrës së saj.

## Eddie Murphy shihet për herë të parë me të fejuarën shtatzënë



**E**ddie Murphy dhe Paige Butcher duken më të lumtur se kurrë, pas fejesës. Çifti është parë në Studio City në California për herë të parë pasi aktori e kishte konfirmuar për revistën "People" se është fejuar muajin e kaluar.

Butcher kishte zgjedhur të vishte një palë pantallona me ngjyrë të zezë dhe një bluzë me krahë të gjatë ngjyrë kafe, kombinuar me një palë atlete të zeza Nike. Komediani 57-vjeçar kishte veshur pantallona dhe bluzë ngjyrë hiri.



## Selena Gomezi, pasi del nga spitali, kërkon ndihmë

**K**ëngëtarja më famë botërore, Selena Gomez, kërkon ndihmë emocionale pas disa javësh 'të ashpra' që përjetoj në spital. 26-vjeçarja u shtrua në spital dy herë brenda javëve të fundit, të dyja rastet ishin për shkak të

rënies së qelizave të bardha, gjë që mund të jetë një efekt anësor për pacientët që kanë bërë transplantimin e veshkave. Selena po përballlet me një gjendje të rëndë emocionale dhe është e rrethuar nga familja e ngushtë.

## Rihanna u bënë thirrje amerikanëve të regjistrohen për të votuar



**R**ihanna i është bashkuar një numri të madh të yjeve që u kanë bërë thirrje fansave të tyre të regjistrohen për të votuar në ShBA. Kjo vjen pasi Taylor Swift iu bashkua Chance the Rapper dhe John Legend në kampanjën e tyre. Periudha e

regjistrimit për t'i votuar pritet të përfundojë së shpejti në një numër të shteteve amerikane, përderisa zgjedhjet afatmesme të nëntorit po afrohen. Rihanna ka postuar një shkrim për 65 milionë ndjekësit e saj në lidhje me këtë regjistrim.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

AUSTRI - IRLANDA VERIUT

X-1

KROACI - ANGLI

3+

BELGJIKE - ZVICER

3+

## Edhe një triumf i Kosovës në 'Fadil Vokrri', rrëzon Maltën

Kosova ka marrë tri pikët e reja nga përballja me Maltën, pasi ishte superiore në stadiumin "Fadil Vokrri", duke shënuar fitore 3-1. Pas ndeshjes, trajneri Bernard Challandes është shprehur mjaft i lumtur. "Tani kemi krijuar një identitet dhe po luajmë futboll të bukur. Zhegrova ishte shumë i mirë në përballjen e sotme. Nuk kemi shumë mbrojtës. Po i kërkojmë dy", ka thënë Challandes



minutën e 12 Edon Zhegrova del përballë portierit Hogg, i cili e ndali gjuajtjen e talentit shqiptar. Tre minuta më vonë mysafirët e bllokojnë edhe gjuajtjen e Valon Berishës, kurse sulmet e Kosovës nuk kishin të ndalur. Rastin e radhës e shpërdori Vedat Muriqi, i cili me kokë gjuan afër shtyllës pingule. Në minutën e 28 dhe 29 Zeneli dhe Muriqi shpërdoruan raste shënimi për Kosovën, por pas gjysme ore lojë Valon Berisha asistoi për mrekuilli deri te Benjamin Kololli që realizoi për rezultatin 1-0. Muriqi më pas e lëshoi edhe një tjetër rast shënimi, derisa Zhegrova në fund të pjesës së parë e goditi shtyllën. Mysafirët në pjesën e parë e regjistruan vetëm një gjysmërast, por Misud nuk u tregua i saktë dhe rezultati i dyzetepesë minutave të parë ishte 1-0. Në fillim të pjesës së dytë Malta e shfrytëzoi një gabim të

vendësve dhe realizoi për 1-1. Autor i golit ishte Andre Agius. Tre minuta më vonë Kosova u mundua ta rikthejë epërsinë, por gjuajtjen e Arbër Zenelit e bllokuan mbrojtësit mysafirë. Në minutën e 61-të Amir Rrahmani provoi të shënojë, por pa ndonjë sukses. Katër minuta më vonë Zhegrova e goditi edhe një herë shtyllën. Në minutën e 68 Vedat Muriqi e rikthejë epërsinë e Kosovës në 2-1, kurse Benjamin Kololli (81') e vulosi rezultatin final 3-1. Pas kësaj fitore Kosova vazhdon të jetë e para në grup me shtatë pikë,

kurse Azerbajxhani është i dyti me 5 pikë, Ishujt Faroe renditen në pozitën e tretë me 3 pikë, Malta e fundit me vetëm 1 pikë. "Kam qenë i përkushtuar vetëm te Kosova. Me rëndësi që shënuam fitore. Djemtë dhanë gjithçka për këtë ndeshje. Sot isha i pafat, por jam i lumtur me paraqitjen e ekipit dhe kjo është me rëndësi për mua. Normalisht atje shkojmë të sulmojmë. Do të përpiqemi ta fitojmë ndeshjen", ka thënë pas ndeshjes Edon Zhegrova.

**Stadiumi "Fadil Vokrri", Prishtinë**  
**Shënues:** Kololli (30, 81), Muriqi (68) për Kosovën, Andre Agius (55) për Maltën  
**Gjyqtarë:** Tomas Bognar, Balazes Buzas, Theodoros Georgiou  
**Kartonë të verdhë:** Kryeziu, Kastrati (Kosova), Agius, Pisani (Malta)  
**Karton të kuq:** Michael Mifsud (Malta)  
**Kosova:** Ujkani, Vojvoda, Rrahmani, Aliti, Kololli, Shala, Kryeziu, Berisha (Halimi), Zeneli (Rashica), Zhegrova, Muriqi (Kastrati).  
**Malta:** Hogg, Mbong, Borg, Agius, Fenech (Briffa), Misfud, Schembri (Effiong), Musact, Failla, Corbolan, Apap.

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 11 TETOR** - Përfaqësuesja e Kosovës nuk njih kundërshtar në stadiumin "Fadil Vokrri", pasi e ka fituar edhe ndeshjen e dytë në Ligën e Kombeve. "Dardanët" të enjten në mbrëmje e kanë mposhtur Kombëtaren e Maltës me rezultat 3-1, kurse dominimi në këtë ndeshje i ka takuar komplet Kosovës. "Tani kemi krijuar një identitet dhe po luajmë futboll të bukur. Zhegrova ishte shumë i mirë në përballjen e sotme. Nuk kemi shumë mbrojtës. Po i kërkojmë dy", ka thënë pas ndeshjes Bernard Challandes, trajner i Kosovës.

Përfaqësuesja e drejtuar nga Bernard Challandes nisi sulmin që nga minuta e katërt kur e rrezikoi portën e skuadrës mysafire, por aksioni përfundoi pa sukses. Në

## KB Prishtina mëson kundërshtarët në FIBA Europe Cup



**PRISHTINË, 11 TETOR** - Pas përfundimit të kualifikimeve për FIBA Europe Cup janë caktuar grupet në këtë garë evropiane në të cilën bën pjesë edhe Z Mobile Prishtina. Prishtina sivjet do të bëjë gara ndaj Bakken Bears, ekipit më të trofeshëm në Danimarkë dhe është pjesëmarrës i rregullt i garave evropiane. Përveç danezëve në grupin E, klubi nga Kosova do të përballë edhe me Cherkaski Mavpyn e Ukrainës dhe Seaua Bucuresti nga Rumania.

"Bakken Bears është skuadra më e trofeshme në Danimarkë me 16 tituj e 11 kupa. Kampioni aktual i Danimarkës është pjesëmarrës i rregullt në garat evropiane dhe vitin që lamë pas ishte edhe në TOP 4 ekipet e FIBA Europe Cup, ku humbi në gjysmëfinale. Cherkaski Mavpy, kampioni aktual në Ukrainë, ku dihet se basketbolli në shtetet e ish-Bashkimit Sovjetik është sport mjaft i zhvilluar. Ukrainasit kanë marrë pjesë edhe më herët në garat evropi-

ane, si FIBA Euro Cup dhe FIBA Europe Cup", thuhet në njoftimin e Prishtinës. Steaua Bucuresti është emër i njohur në sportin evropian. 21 herë kampion i Rumanisë dhe dikur ishte renditur e treta në Euroleague. Traditë të madhe në basketboll si në Superligën rumune, ashtu si edhe dy ekipet e tjera të grupit, me përvojë të madhe në Evropë. Z Mobile Prishtina në ndeshjen e parë më 16 tetor e pret kampionin ukrainas Cherkaski Mavpy.

## Ndërroi jetë futbollisti shqiptar Labinot Harbuzi

**PRISHTINË, 11 TETOR** - Një ngjarje e rëndë ka tronditur botën e futbollit. Mesfushori me origjinë shqiptarë, Labinot Harbuzi, ka ndërruar jetë të enjten. Lajmi është konfirmuar nga babai i Labinotit, Ismeti, i cili tregon për mediet suedeze, se rreth orës 10.00 të mëngjesit 32-vjeçari u rrëzua në shtëpi pas një sulmi

në zemër. Edhe pse ai u transportua me ambulancë në spital, nuk arriti të shpëtonte. Karriera e Harbuzit ishte tepër e pasur, teksa u aktivizua me klube si Fejnord, Ekselsor, Malmo, Genclerbirlik, Nanisaspor, Syrianska dhe, së fundi, ishte pjesë e Malaka Junajtid. Për sa iu përket kombëtareve, mesfushori

u aktivizua me moshat e Suedisë, pa arritur të debutojë në kombëtaren A. Në vitin 2010 Labinoti ishte i gatshëm t'i bashkoheshe përfaqësuesë shqiptarë, por kërkesa e tij nuk u miratua nga FIFA. 32-vjeçari kishte raporte të shkëlqyera me legjendën Zlatan Ibrahimović, i cili në një intervistë të dhënë për

"Sportbladet" i thuri elozhe Harbuzit, duke e vlerësuar për cilësitë e tij dhe për personalitetin që kishte. Nga 1 janari i vitit 2017, 32-vjeçari ishte pa klub. Dy javë më parë ai deklaroi për një revistë sportive se karriera e tij nuk kishte marruar, por fati e deshi që ai të mbyllte diçka në mënyrë tragjike.





## Liga e Medieve: "Ora Info" përballë "Epokës së re"

PRISHTINË, 11 TETOR - Java e pestë e Media Ligës në futboll pritet të jetë interesante. Një nga ndeshjet kryesore pritet të jetë në mes të ekipit të "Lajmi.net" dhe ekipit të "Gazeta Metro", pasi këto dy ekiye kanë arritur rezultate të

mira dhe renditen në pozitën e dytë, përkatësisht të katërt. Kryesuesja e ligës, "Epoka e re", do të luajë ndaj ekipit të "Ora Info"-s dhe kjo ndeshje pritet të sjellë rivalitet të madh për faktin se "Epoka" synon ta ruajë poz-

itën e parë, ndërsa "Ora" ta regjistrojë fitoren e tretë. "Klan Kosova" do të luajë ndaj "Kallxo.com", kurse "Media Works" përballë me ekipin e "Gazetës Zëri". Java e pestë: "Media Works" -

"Gazeta Zëri", "InfoKosova PrishtinaPost" - "Infokusi", "Ora Info" - "Epoka e re", "Gazeta Blic" - "Telegrafi", "Kallxo.com" - "Klan Kosova", "RTV Dukagjini" - "D+", "RTK" - "KosovaPress", "Lajmi.net" - "Gazeta Metro".



## Dumnica largohet nga Llapi

PRISHTINË, 11 TETOR - Nexhat Dumnica nuk është më kryetar i KF Llapi pasi ka vendosur përfundimisht të largohet nga ky klub për shkak të situatës së fundit që kulmoi edhe me largimin e trajnerit Bylbyl Sokoli. Kontributi i Dumnicës për vite me radhë ka qenë i madh në skuadrën e Llapi, kurse largimin nga kjo skuadra ai vendosi ta bëjë publik nëpërmjet një postimi në "Facebook". "Duke e parë këtë atmosferë e cila kaloi përtej sportiviteti, rasti i sulmit ndaj prof. Bylbyl Sokolit, e cila po mbretëron që nga fillimi i kampionatit dhe ku nuk na u dha mundësia ta japim kontributin tonë sipas planit të paraparë, unë jap dorëheqje nga të gjitha funksionet në KF Llapi dhe lëshoj rrugë për ata që kanë vizion, ide dhe aftësi menaxheriale, sportive dhe financiare më të avancuara për ta çuar klubin përpara", ka thënë Dumnica, i cili ka konfirmuar se kontributi dhe ndihma e tij ndaj vendlindjes dhe qytetit të Podujevës do ta vazhdojë në forma të ndryshme. Dumnica ka folur edhe për synimet e



klubit që kishte në pesë vjetet e fundit, shpenzimet dhe reformat e bëra. "Në këta pesë vjet kemi pasur sfida të ndryshme për ngritjen e KF Llapi. Qëllimi ynë gjithmonë ishte titulli i parë kampion. Për pesë vjet rresht kam mbështetur KF Llapi financiarisht në aspektin menaxherial dhe kohor, rezultatet ishin ato që edhe vetë ju keni qenë dëshmitarë, kurse për këto pesë vjet shpenzimet ishin të mëdha duke krahasuar ekipet e tjera të Superligës, derisa objektivat tona për titullin kampion apo pjesë-

marrja në Evropë nuk u realizuan", ka deklaruar Dumnica, duke shtuar: "Për t'i realizuar objektivat tona ishte më se e domosdoshme një reformë e brendshme, kjo gjë u arrit dhe u bë edhe zgjerimi i aksionarëve për të siguruar një stabilitet financiar afatgjatë për KF Llapi. Po ashtu shtabi teknik u pasurua me kuadro profesionale për t'i arritur objektivat tona, ky ishte plani për KF Llapi i cili nuk gjeti përkrahje të plotë dhe u krijua një atmosferë për të cilin edhe jeni në dijeni".

## Mamaja e Ronaldos, pas akuzave për përdhunim: 'Zoti është i madh'

TORINO, 11 TETOR - Mamaja e Cristiano Ronaldos ka premtuar mbështetjen e saj për djalin, ndërsa pesë herë fituesi i "Topit të Artë" vazhdon të përballë me akuzat publike për përdhunim. Kathryn Mayorga pretendon se superstari i Juventusit e sulmoi atë seksualisht në një suitë, në "Palms Casino Resort" të Las Vegasit, në nëntor të vitit 2009. Çifti u takua në klubin e natës më parë, atë ditë, para se gruaja amerikane të ftohej nga Ronaldo për t'u bashkuar me të në suitën e tij me çati. Zonja Mayorga e ka paditur Ronaldon, duke hedhur poshtë marrëveshjen që ajo nënshkroi me futbollistin e njohur, pas incidentit të pretenduar dhe marrjes së një shume të majme financiare për të heshtur, raporton "Telesport". Megjithatë, mamaja e ish-futbollistit të Real Madridit, Maria Dolores dos Santos Aveiro, ka postuar një mesazh në rrjetet sociale, ku i jep mbështetje djalit të saj. Krahas një fotoje të saj në divan, ajo la këtë status: "Edhe pse jemi



larg prej teje, gjithçka do të jetë mirë. Zoti është i madh". Zonja Mayorga e përshkroi akuzën si përdhunim në intervistën e saj me "Der Spiegel", megjithëse dokumentet ligjore nuk e kanë vërtetuar këtë gjë. Ylli portugez lëshoi një deklaratë në rrjetet sociale të mërkurën për ta pastruar emrin e vet dhe mohoi akuzën për përdhunim. "I mohoj në mënyrë të vendosur akuzat që po

bëhen kundër meje. Përdhunimi është një krim i neveritshëm, që shkon kundër çdo gjëje që unë jam dhe besoj. I etur, siç mund të jem unë për ta pastruar emrin tim, refuzoj ta ushqej spektaklin e krijuar nga njerëz që kërkojnë ta promovojnë veten e tyre me emrin tim. Ndërgjegjja ime është e pastër dhe do të më lejojë të pres me qetësi rezultatet e çdo hetimi", ka thënë Ronaldo.

### SHKURT

#### Greza: Ndaj Izraelit japim maksimumin

Shqipëria nuk shkoi më shumë se një barazim pa gola në miqësoren ndaj Jordanisë, ndërsa Eros Greza ishte një nga "notat" më të bukura të përfaqësueses së Christian Panuccit, në prag të transfertës delikate në Izrael. "Trajneri vendosi të eksperimentojë me një skemë 3-5-2 dhe dëshiron ta shikonte gjendjen e disa lojtarëve. Nuk zhvilluam një ndeshje të mirë, duke nisur që nga unë, që nuk jam në formën më të mirë, pasi vij nga një dëmtim dhe nuk jam stërvitur maksimalisht. Gjithsesi shpresoj se me Izraelin gjithçka të jetë ndryshe dhe t'i marrim tri pikët", ka thënë Greza.

#### Dzekon dhe El Shaarawy rinovojnë kontrata me Romën

Roma ka nisur bisedimet me Edin Dzekon dhe Stephan El Shaarawy për zgjatjen e kontratave të tyre të cilat skadojnë në vitin 2020. Boshnjaku pritet të firmosë deri në 2021, ndërsa ish-milanisti deri në vitin 2022. Në këtë mënyrë kryeqytetasit u paraprijnë "sulmeve" që mund të vijnë gjatë afatit kalimtar të janarit. Si Dzeko ashtu edhe El Shaarawy pritet t'i rinovojnë kontratat e tyre në fund të këtij sezoni, të cilat do të kenë edhe ndryshime sa iu takon pagave të lojtarëve që normalisht do të pësojnë rritje.

#### Monaco shkarkon trajnerin Jardim

Skuadra e Monacos dhe trajneri Leonardo Jardim kanë arritur marrëveshje për ndërprerjen e bashkëpunimit katërvjeçar. Lajmi është bërë me dije në faqen zyrtare të Monacos, ku edhe është shprehur mirënjohje dhe falënderim për trajnerin 44-vjeçar. Jardim e ka drejtuar Monacon gati katër sezone, duke qëndruar në bankinë 233 herë dhe gjatë drejtimit të tij, skuadra franceze ka fituar edhe një titull të kampionit.

#### Ballacku: Habitem që Lowi është ende trajner i Gjermanisë

Federata Gjermane e Futbollit (DFB) rikonfirmoi Joachim Low në krye të kombëtares, pavarësisht se "Die Mannschaft" nuk kaloi as fazën e grupeve. Kjo gjë e habit shumë ish-mesfushorin Michael Ballack. "Ashtu si shumë njerëz të tjerë, edhe unë u habita që Low vazhdon të jetë trajneri. Kur ke shumë kohë në një skuadër, vjen një moment kur gjërat nuk funksionojnë më", ka thënë Ballack për "Deutsche Welle". Ish-lojtari i Bayern Munchenit kritikon DFB-në: "Duhet analizuar gjërat. Nuk mund të thuash 'do të bëjmë analizë' kur e ke ndarë mendjen për ta mbajtur trajnerin. Nuk është analizë kjo".

#### Manqini: Po krijojmë shumë raste, por po shënojmë pak gola

Kombëtarja e Italisë nuk ka arritur të marrë më shumë se një barazim përballë Ukrainës që drejtohet nga Andriy Shevchenko. Trajneri Roberto Manqini, pas ndeshjes, ka thënë se dështimi për të shënuar gola është mangësia më e madhe e ekipit të tij. "Ishte një mëkat që nuk fituam por, me sa duket, i tillë është ky moment për ne. Ndryshe nga ndeshjet e tjera, sivjet ndërtoam shumë, por shënuam fare pak dhe kjo është mangësia më e madhe që kemi treguar gjatë aventurës sime këtu", ka thënë Manqini.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Agjencia Kosovare e Privatizimit është e ngarkuar për të privatizuar Ndërmarrjet Shoqërore në Kosovë përmes metodës së spin-off-it dhe likuidimit. Investitorët ftohen t'i blejnë përmes tenderit të hapur dhe konkurrues asetet e disa NSH-ve në likuidim të radhitura më poshtë.

### AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT

## SHALL SHITJEN E 42-të TË ASETEVE TË NDËRMARRJEVE NË LIKUIDIM

Subjektet / njësitet e përcaktuara më poshtë janë nën juridiksionin e AKP-së në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-034 për Privatizim mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Ofertat e mbyllura për njësitet në vijim duhet të dorëzohen në "Sallën e konferencave - Hotel Grand" në Prishtinë, më 07 nëntor 2018, ndërmjet orës 10:00 dhe 12:00 (sipas kohës lokale të Evropës Qendrore), dhe të shoqëruara nga depozita e ofertës dhe tarifa për paraqitjen e ofertës, siç është parashikuar për secilin artikull. Të gjitha ofertat duhet të paraqiten në përputhje me Rregullat e Tenderit të zbatueshme për shitjet me likuidim. Të gjitha njësitet e radhitura këtu ofrohen për shitje mbi bazën "siç është" dhe "ku është" dhe do të shiten në përputhje me termet ligjore dhe kushtet e shitjes. Veçanërisht dhe pa ndryshuar kushtet e tilla, AKP nuk jep garanci, qoftë të shprehur apo të nënkuptuar, sa i përket gjendjes apo përshkrimit të njësive që shiten ose përshtatshmërisë së tyre për ndonjë përdorim apo qëllim. Verifikimi i përshkrimit dhe gjendjes së të gjithë njësive të listuara këtu është përgjegjësi e ofertuesit.

**Njësia nr.01: Pasuria Bujqësore Toka në Sojevë** - ofron për shitje tokën bujqësore me sipërfaqe të përgjithshme prej 5957m<sup>2</sup> (59ari 57m<sup>2</sup>), në ZK dhe në afërsi të fshatit Sojevë në Komunën e Ferizajt, e cila është e përshtatshme për veprimtari bujqësore. **(Depozita e ofertës: € 5,000)**  
**Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:**  
N.Sh „Pasuria Bujqësore“ Ferizaj Fi-650/89

**Njësia nr.02: KB Zhegra Toka në Lladovë** - ofron për shitje tokën bujqësore me sipërfaqe të përgjithshme prej 5575m<sup>2</sup> (55ari 75m<sup>2</sup>), në ZK dhe në afërsi të fshatit Lladovë, në Komunën e Gjilanit, e cila është e përshtatshme për veprimtari bujqësore. **(Depozita e ofertës: € 3,000)**  
**Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:**  
KB Zhegra Fi-529/98

**Njësia nr.03: KB Zhegra Toka në Zhegër** - ofron për shitje tokën bujqësore me sipërfaqe të përgjithshme prej 12276m<sup>2</sup> (01ha 22ari 76m<sup>2</sup>), në ZK dhe në afërsi të fshatit Zhegër, në Komunën e Gjilanit, e cila është e përshtatshme për veprimtari bujqësore. **(Depozita e ofertës: € 5,000)**  
**Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:**  
KB Zhegra Fi-529/98

**Njësia nr.04: Agromorava Toka në Sllatinë të Poshtme (Lot C)** - ofron për shitje tokën në sipërfaqe prej 35887m<sup>2</sup> (3ha 58ari 87m<sup>2</sup>), në ZK dhe në afërsi të fshatit Sllatinë të Poshtme, në Komunën e Vititë. Lokacioni është i përshtatshëm për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme afariste. **(Depozita e ofertës: € 12,000)**  
**Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:**  
P.I.P.P.Agromorava Fi-229/89

**Njësia nr.05: Agromorava Toka në Viti (Lot C)** - ofron për shitje tokën bujqësore me sipërfaqe të përgjithshme prej 948m<sup>2</sup> (9ari 48m<sup>2</sup>), në ZK dhe në Komunën e Vititë, e cila është e përshtatshme për veprimtari bujqësore. **(Depozita e ofertës: € 1,000)**  
**Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:**  
P.I.P.P.Agromorava Fi-229/89

**Njësia nr.06: IMK Fabrika e Tubave Lokali në Ferizaj** - ofron për shitje lokalin përdhes i cili sipas Certifikates Kadastrale të Njësive dhe sipas matjeve interne të AKP-së (me laser/metër) është në sipërfaqe prej 92m<sup>2</sup>. Lokali përdhes gjendet në kuadër të ndërtesës së banimit kolektiv (P+5), në Rr. Dëshmorët e Kombit, Komuna e Ferizajt. Lokali është i përshtatshëm për zhvillimin e llojeve të ndryshme të biznesit komercial. **(Depozita e ofertës: € 50,000)**  
**Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:**  
NSh "IMK Fabrika e Tubave" Fi-784/89

**Njësia nr.07: Kualiteti Lokali në Gjilan** - ofron për shitje lokalin i cili sipas matjeve interne të AKP-së (me laser/metër) është në sipërfaqe prej 86.12m<sup>2</sup>, ndërsa sipas Listës së Aseteve është në sipërfaqe prej 77.52m<sup>2</sup>. Lokali gjendet në kuadër të ndërtesës së banimit kolektiv (P+4), në Rr. Bujanina, Komuna e Gjilanit. Lokali është i përshtatshëm për zhvillimin e llojeve të ndryshme të biznesit komercial. **(Depozita e ofertës: € 12,000)**  
**Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:**  
NSh "Kualiteti" Fi-888/89 & SHA Kualiteti

**Njësia nr.08: Pasuria Bujqësore Toka në Kosinë (Lot B)** - ofron për shitje tokën bujqësore me sipërfaqe të përgjithshme prej 11677m<sup>2</sup> (1ha 16ari 77m<sup>2</sup>), në ZK dhe në afërsi të fshatit Kosinë në Komunën e Ferizajt, e cila është e përshtatshme për veprimtari bujqësore. **(Depozita e ofertës: € 7,000)**  
**Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:**  
N.Sh „Pasuria Bujqësore“ Ferizaj Fi-650/89

**Njësia nr.09: Agrokultura Toka në Gjilan (Lot M)** - ofron për shitje tokën me sipërfaqe të përgjithshme prej 1763m<sup>2</sup> (17ari 63m<sup>2</sup>), tek vendi i quajtur Zabel i Sait Agës, në ZK Gjilan, e përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme afariste. **(Depozita e ofertës: € 2,000)**  
**Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:**  
NSH KBI "MLADOST" Fi-670/89, Fi-106 /78, Fi-1865/96

**Njësia nr.10: Pasuria Bujqësore Toka në Tankosiç (Lot A)** - ofron për shitje për tokën bujqësore në sipërfaqe përgjithshme prej 11242m<sup>2</sup> (1ha 12ari 42m<sup>2</sup>), në ZK dhe në afërsi të fshatit Tankosiç, Komuna e Ferizajt, e cila është e përshtatshme për veprimtari bujqësore. **(Depozita e ofertës: € 6,000)**  
**Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:**  
NSh Pasuria Bujqësore Ferizaj Fi-650/89

**Njësia nr.11: Produkti Parcelat 00851-0 dhe 00852-0 në Klinën e Epërme** - Kjo shitje ofron tokën bujqësore me sipërfaqe 38045m<sup>2</sup> (3ha 80ari 45m<sup>2</sup>), në ZK Klinë e Epërme, Komuna e Skenderajt. **(Depozita e ofertës: € 12,000)**  
**Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:**  
NSH Produkti - Skenderaj Fi-727/89; Fi-8163/92; Fi-2694/94; Fi-140/95;  
UNMIK regj. nr.80483651

**Njësia nr.12: Produkti parcelat 755-0 dhe 797-0 në Kopiliq i Poshtëm** - Kjo shitje ofron tokën bujqësore me sipërfaqe 15724m<sup>2</sup> (1ha 57ari 24m<sup>2</sup>), në ZK Kopiliq i Poshtëm, Komuna e Skenderajt. **(Depozita e ofertës: € 6,000)**  
**Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:**  
NSH Produkti - Skenderaj Fi-727/89; Fi-8163/92; Fi-2694/94; Fi-140/95;  
UNMIK regj. nr.80483651

**Njësia nr.13: NSH Produkti Tokë në Dashevc** - Kjo shitje ofron tokën bujqësore me sipërfaqe prej 56277m<sup>2</sup> (5ha 62ari 77m<sup>2</sup>), në ZK Dashevc, Komuna e Skenderajt. **(Depozita e ofertës: € 20,000)**  
**Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:**  
NSH Produkti - Skenderaj Fi-727/89; Fi-8163/92; Fi-2694/94; Fi-140/95;  
UNMIK regj. nr.80483651

**Njësia nr.14: Elan Parcela 114-1 ZK Stanovc i Epërm/Përronaj** - Kjo shitje ofron tokën bujqësore me sipërfaqe 6696m<sup>2</sup> (66ari 96m<sup>2</sup>), në ZK Përronaj/Stanovc i Epërm, Komuna e Vushtrrisë. **(Depozita e ofertës: € 4,000)**  
**Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:**  
NSHB Elan - Vushtrri Fi-791/89; JSC Ratar Fi-7899/92; N.SH.B. Elan UNMIK Reg.nr. 80025629

**Njësia nr.15: Lokali Afarist nr.2** - Kjo shitje ofron lokalin me sipërfaqe prej 72m<sup>2</sup> sipas listës së asetëve të NSH-së, ndërsa 70.70m<sup>2</sup> sipas matjeve në terren, i cili është pjesë etazhore e një ndërtese afariste-banesore në sheshin "Fehmi Lladrovci" në qendër të Glllogocit. Toka nuk është pjesë e shitjes. Prona aktualisht është në qiradhënie. **(Depozita e ofertës: € 100,000)**  
**Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:**  
AIK "Agrokosova"; OPBQ "Drenica"; "Ferma e Brojlerëve"; NSHBQ "Drenica" (Fi-714/89); Holding "Yuko"; DD PO Zitiste (Fi-4340/93); "Yuko-Drenica" DD sa PO Glogovac Fi-3481/94, Fi-1722/96 UNMIK Reg.nr. 80151721

**Njësia nr.16: Lux Lokali "Nashe Dete"** - Kjo shitje ofron lokalin me sipërfaqe prej 81m<sup>2</sup> sipas listës së asetëve, ndërsa sipas matjeve në terren lokali ka sipërfaqe prej 79m<sup>2</sup>. Lokali gjendet në rrugën "Kral Petar I" në Mitrovicën Veriore. Prona aktualisht është në qiradhënie. **(Depozita e ofertës: € 12,000)**  
**Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:**  
N.Sh. "Lux" Fi-200/89; Fi-6273/92

**Njësia nr.17: Toka në Gërgoc** - Kjo shitje ofron tokën në sipërfaqe prej 84ari 99m<sup>2</sup> (8499m<sup>2</sup>) në ZK Gërgoc, Komuna Gjakovë. Prona ka qasje në rrugë publike. Nuk ka marrëveshje për shfrytëzimin e pronës. **(Depozita e ofertës: € 7,000)**  
**Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:**  
KB "Bec", Bec Fi-391/90

**Njësia nr.18: Parcela nr.239 në Gërgoc** - Kjo shitje ofron tokën në sipërfaqe prej 61ari 24m<sup>2</sup> (6124m<sup>2</sup>) në ZK Gërgoc, Komuna Gjakovë. Prona ka qasje në rrugë publike. Nuk ka marrëveshje për shfrytëzimin e pronës. **(Depozita e ofertës: € 5,000)**  
**Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:**  
KB "Bec", Bec Fi-391/90

**Njësia nr.19: Parcela nr.726-3 në Gllarevë** - Kjo shitje ofron tokën me sipërfaqe 16ari 24m<sup>2</sup> (1624m<sup>2</sup>) në ZK Gllarevë, Komuna Klinë. Prona ka qasje në rrugë publike lokale, si dhe është në afërsi të magjistrales Pejë- Prishtinë. **(Depozita e ofertës: € 1,000)**  
**Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:**  
Ndërmarrja Shoqërore Tregtare Prodhuese "Produkt" p.p., Pejë Fi-659/89

**Njësia nr.20: Toka Bujqësore Damjan 4** - Kjo shitje ofron tokën me sipërfaqe të përgjithshme prej 3ha 69ari 18m<sup>2</sup> (36918m<sup>2</sup>), e evidentuar në parcelat nr.746-0, 747-0 dhe 1148-0, që ndodhet në ZK Damjan, Gjakovë. **(Depozita e ofertës: € 25,000)**  
**Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:**  
KB "Rogova", Rogovë, Gjakovë

**Njësia nr.21: Parcelat 300-1 dhe 300-2 në Lubovë** - Kjo shitje ofron tokën me sipërfaqe të përgjithshme 1ha 96ari 33m<sup>2</sup> (19633m<sup>2</sup>), e evidentuar në parcelën nr. 300-1 dhe 300-2, që ndodhet në ZK Lubovë, Komuna Istog. **(Depozita e ofertës: € 10,000)**  
**Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:**  
NSH "Dubrava", Istog Fi-268/89

**Njësia nr.22: Parcela nr.239 në Kosuriq** - Kjo shitje ofron tokën bujqësore me sipërfaqe prej 2ha 41ari 42m<sup>2</sup> (24142m<sup>2</sup>), ZK Kosuriq, Komuna Pejë. Nuk ka marrëveshje për shfrytëzimin e pronës. **(Depozita e ofertës: € 15,000)**  
**Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:**  
KB "Baran" Fi-169/81

**Njësia nr.23: Toka në Kosuriq** - Kjo shitje ofron tokën e cila përfshinë ngastrat kadastrale: parcelat nr. 2-8, 3-6, 3-7, 3-9, 3-14, 7-1, 7-3 në ZK Kosuriq, me sipërfaqe prej 3ha 05ari 49m<sup>2</sup> (30549m<sup>2</sup>), Komuna Pejë. Nuk ka marrëveshje për shfrytëzimin e pronës. **(Depozita e ofertës: € 20,000)**  
**Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:**  
Ndërmarrja e Përbërë KBI "Dushan Mugosha - Duq", Pejë me p.s.p. Fi-525/89; Fi-753/89; KBI "Bujqësia" SHA, Pejë Fi-1922/92; N.P.B. "Bujqësia" - Pejë 80115326 (2001)

**Njësia nr.24: Parcela nr. 1-26 në Ramun** - Kjo shitje ofron tokën me sipërfaqe prej 84ari 96m<sup>2</sup> (8496m<sup>2</sup>) me kulturë kullosë e klasës 2 që ndodhet në ZK Ramun, Komuna Pejë. Prona ka qasje në rrugë publike. Toka është pjesërisht e punuar. Nuk ka ndonjë marrëveshje për shfrytëzimin e asetit në shitje. **(Depozita e ofertës: € 7,000)**  
**Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:**  
NSH TSP "Agrometohija" Fi-407/89; NT "Agrodukagjini" UNMIK reg. nr. 80007329

**Njësia nr.25: NSH Kooperimi - Tokë bujqësore Vitomirica 1** - përfshinë tokën me sipërfaqe prej 2ha 61ari 21m<sup>2</sup> (26121m<sup>2</sup>) në ZK Vitomiricë, Komuna Pejë. Prona nuk ka qasje në rrugë publike. Ekziston marrëveshje qiraje për shfrytëzim. **(Depozita e ofertës: € 20,000)**  
**Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:**  
KBI "Dushan Mugosha - Duq" në Pejë Fi-573/89

**Njësia nr.26: KB Dubrava - Toka bujqësore në Gurrakoc** - përfshin tokën me sipërfaqe të përgjithshme prej 3ha 83ari 89m<sup>2</sup> (38389m<sup>2</sup>) në ZK Gurrakoc, Komuna Istog. Nuk ka marrëveshje për shfrytëzimin e pronës. **(Depozita e ofertës: € 15,000)**  
**Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:**  
NSH "Dubrava", Istog Fi-268/89

Vijon në faqen e dytë

Vijon nga faqja e parë



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

**Njësia nr.27: NSH Deva ngastrale kadastrale nr.705 ZK Devë** - përfshin parcelën me sipërfaqe 12ari 10m<sup>2</sup> (1210m<sup>2</sup>) në ZK Devë, Komuna Gjakovë. Në të kaluarën, prona është përdorur si deponi hiri nga Ndërmarrja. Nuk ka marrëveshje për shfrytëzimin e pronës. **(Depozita e ofertës: € 500)**  
**Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:**  
NMMKI "Deva" p.p., Gjakovë Fi-497/89

**Njësia nr.28: Ratar Tokë Bujqësore Graçanicë II** - Kjo shitje ofron tokën bujqësore me sipërfaqe të përgjithshme prej 5925m<sup>2</sup> (59ari 25m<sup>2</sup>) ZK Graçanicë, Komuna Graçanicë. **(Depozita e ofertës: € 2,500)**  
**Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:**  
NSH "Ratar" Llapllasellë (më parë pjesë e KBI "Kosova Export"), Fi-809/89

**Njësia nr.29: Ratar Tokë Bujqësore Graçanicë III** - Kjo shitje ofron tokën bujqësore me sipërfaqe të përgjithshme prej 22868m<sup>2</sup> (2ha 28ari 68m<sup>2</sup>) ZK Graçanicë, Komuna Graçanicë. **(Depozita e ofertës: € 15,000)**  
**Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:**  
NSH "Ratar" Llapllasellë (më parë pjesë e KBI "Kosova Export"), Fi-809/89

**Njësia nr.30: Ratar Tokë Bujqësore Livagjë** - Kjo shitje ofron tokën bujqësore me sipërfaqe të përgjithshme prej 5490m<sup>2</sup> (54ari 90m<sup>2</sup>) ZK Livagjë, Komuna Graçanicë. **(Depozita e ofertës: € 4,500)**  
**Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:**  
NSH "Ratar" Llapllasellë (më parë pjesë e KBI "Kosova Export"), Fi-809/89

**Njësia nr.31: Ratar Tokë Bujqësore Uglar I** - Kjo shitje ofron tokën bujqësore me sipërfaqe të përgjithshme prej 5386m<sup>2</sup> (53ari 86m<sup>2</sup>) ZK Uglar, Komuna Graçanicë. **(Depozita e ofertës: € 3,000)**  
**Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:**  
NSH "Ratar" Llapllasellë (më parë pjesë e KBI "Kosova Export"), Fi-809/89

**Njësia nr.32: Ratar Tokë Bujqësore Uglar II** - Kjo shitje ofron tokë bujqësore me sipërfaqe prej 83558m<sup>2</sup> (8ha 35ari 58m<sup>2</sup>) ZK Uglar, Komuna Graçanicë. **(Depozita e ofertës: € 35,000)**  
**Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:**  
NSH "Ratar" Llapllasellë (më parë pjesë e KBI "Kosova Export"), Fi-809/89

**Njësia nr.33: Ratar Tokë Bujqësore Uglar III** - Kjo shitje ofron tokë bujqësore me sipërfaqe prej 16756m<sup>2</sup> (1ha 67ari 56m<sup>2</sup>) ZK Uglar, Komuna Graçanicë. **(Depozita e ofertës: € 9,000)**  
**Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:**  
NSH "Ratar" Llapllasellë (më parë pjesë e KBI "Kosova Export"), Fi-809/89

**Njësia nr.34: KB Flora Tokë Bujqësore Dobërdol** - Kjo shitje ofron tokë bujqësore me sipërfaqe prej 38738m<sup>2</sup> (3ha 87ari 38m<sup>2</sup>) ZK Dobërdol, Komuna Podujevë. **(Depozita e ofertës: € 5,000)**  
**Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:**  
KB "Flora" Kerpimeh Fi-29/91, ZZ "Kerpimej" Regj. Biz. UNMIK 80119674

**Njësia nr.35: KB Kosova Tokë Bujqësore Livagjë IV** - Kjo shitje ofron tokën bujqësore me sipërfaqe të përgjithshme prej 11862m<sup>2</sup> (1h 18ari 62m<sup>2</sup>) ZK Livagjë, Komuna Graçanicë. **(Depozita e ofertës: € 5,000)**  
**Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:**  
KB "Kosova"; KB Lipjan; SHA "Poljoprivreda"; Fi-7667/92, Fi-3890/94

